



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.5.2022, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit tre javor të punës për datat 9 – 27 maj 2022
2. Projektligji “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etilda Gjonaj, Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Hatixhe Konomi, Pandeli Majko, Lavdrim Krashi, Tritan Shehu, Greta Bardeli, Bardhyl Kollçaku, Vangjel Dule, Klodiana Spahiu, Kreshnik Çollaku, Grida Duma, Petro Koçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Tomor Alizoti

Mungojnë:

Shpëtim Idrizi, Belind Këlliçi, Grida Duma

Të ftuar:

Elva Margariti - Ministre e Kulturës

Almira Xhembulla - Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Entela Cipa - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Kozeta Angjeliu - Drejtore e Drejtorisë së Programeve për Zhvillimin e Kulturës

Daniel Pirushi - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit

Klodiana Marika - Drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit

Martin Mata - Drejtor i AADF

Aleksandër Sarapuli - Drejtor i AADF

Illir Parangoni - Menaxher Projekti për Kulturën dhe Eko Turizmin

Ekflodia Leskaj - Këshilltare Ligjore, AADF

Luan Perzhita - Rektor i Akademisë të Studimeve Albanologjike

Belisa Muka - Drejtore e Institutit të Arkeologjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit të datës 10 maj të vitit 2022.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit trijavor të punës për datat 7-26 maj, si edhe miratimin e projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”. Komision ynë është komision për dhënie mendimi. Reaktor është kolegja Konomi, ne jemi komision për dhënie mendimi.

Të ftuar kemi ministren e Kulturës zonjën Margariti, zëvendësministren zonjën Xhembulla, dhe gjithashtu: Entela Cipa, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, Kozeta Angjeliu, drejtore e Drejtorisë së Programeve për Zhvillimin e Kulturës, Daniel Pirushi, drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, Klodiana Marika, Drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Martin Mata, Drejtor i AADF-së, Aleksandër Sarapuli, Drejtor i AADF-së, Ilir Parangoni, menaxher projekti për kulturën dhe Eeko Turizmin, Ekflodia Leskaj, këshilltare ligjore në AADF, Luan Perzhita, rektor i Akademisë të Studimeve Albanologjike, Belisa Muka, drejtore e Institutit të Arkeologjisë.

Kënaqësi që ju kemi sot këtu!

Kalojmë pa humbur kohë në miratimin e kalendarit trijavor të punës. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji aq shumë i debatuar. Zonja Ministre, fjala për ju. Jemi në seancën e dhënies së përgjigjeve, sepse e kemi konsumuar përpara pyetjet.

Elva Margariti - Faleminderit!

Vijmë para jush sot për të diskutuar projektligjin “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Keni ndjekur valën e nxehtë të diskutimeve, ngritur mbi hamendësime dhe informacione të paqena për këtë proces.

Ju falënderoj që jemi rikthyer përsëri sot pas seancë së parë që zhvilluam së bashku për të qenë tërësisht transparentë dhe për të shkëmbyer jo vetëm informacione por edhe sugjerime ose korrigjime të vazhdueshme!

Ky projektligj del në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, dhe pikës 5 të nenit 172 të ligjit nr. 27 të vitit 2018 dhe në zbatim të planit të menaxhimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr 583, 22 korrik 2020, një vendim ky bashkë propozim i Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Më lejoni t'ju rikujtoj se ligji nr. 27 i vitit 2018, i cili parashikon këtë formë administrimi i është nënshtruar një procesi të gjatë konsultimesh me institucionet e publike, personalitete të fushës akademike, Institutin e Arkeologjisë dhe është evidentuar një tabelë e gjatë diskutimesh. Ka qenë kjo një nga pyetjet e shtruar edhe në seancën e mëparshme dhe këto konsultime publike janë dorëzuar në Kuvend që në atë kohë në zbatim të nenit 59 të Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë funksionet dhe kompetencat e ministrit të përgjegjës për trashëgiminë kulturore janë të specifikuar dhe të listuar në nenet 12 dhe 13 të projektligjit, duke garantuar ushtrimin uniform të funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Edhe pse pasuritë kulturore në pronësi shtetërore mund të jenë huazuar ose dhënë në përdorim enteve ose subjekteve të ndryshme nga ministria vlen të theksohet se para miratimit të tij nga Kuvendi ky projektligj është konsultuar si me UNESCO-n ashtu edhe me organet konsultuese IKOMOS, IKUM dhe ICROM dhe komentet e tyre janë reflektuar në projektligj,

Duke u bazuar po njësoj në bazën ligjore ligji për trashëgiminë është në përputhje si me nenet 121 dhe 123 të Kushtetutës ku përcaktohet se çdo marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar, është pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe konkretisht bëhet fjalë për konventat e UNESCO-s ku Shqipëria bën pjesë, konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paprekshme të vitit 2006, konventës për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore të vitit 2007 si edhe konventës për mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit dhe eksportit, transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore të vitit 2002.

Është e rëndësishme të theksojmë këto konventa pasi ka qenë edhe kjo pjesë e një diskutimi më të gjerë të mëparshëm jo vetëm në këtë komision, por edhe në komisione të tjera. Konventa e vitit 1972, konventa e UNESCO-s përcakton qartazi në nenit 4, 5 dhe 17,

detyrimet e palës shtet të cilat janë totalisht të respektuara si në ligjin e vitit 27 të vitit 2018 ashtu edhe në marrëveshjen e administrimit që po sjellim për ratifikim pranë jush sot.

Konventa europiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike dhe konventa për vlerën e trashëgimisë kulturore kanë qenë pjesë e vlerësimeve dhe kuadrit ligjor që është marrë parasysh dhe ka përafuar legjislacionin shqiptar me *acquis* të BE-së në fushën e kulturës, konkretisht direktivën e Këshillit të Europës dhe PE-së për kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shtetit anëtar dhe rregulloren e Këshillit të Europës 116 të vitit 2009, datë 28 dhjetor të vitit 2008 për eksportin e mallrave kulturore.

Në komisionin parlamentar përgjegjës, në Komisionin e Ekonomisë, dje ligji është miratuar në parim dhe marrëveshja e administrimit që propozojmë për të miratuar vjen si një prej risi e të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në parashikimin e formave të reja të menaxhimit të pasurive kulturore siç është menaxhimi administrimi indirekt që synon një administrim më efektiv të pasurive kulturore.

Në pikën 5 të nenit 272 të ligjit 27 të vitit 2018 parashikohet pikërisht se ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshje me fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore për administrimin sipas këtij neni dhe kjo marrëveshje i nënshtrohet miratimit, si nga ana e Këshillit të Ministrave, në rastin e administrimit të pasurive kulturore me rëndësi kombëtare dhe lokale dhe miratimi në Kuvend siç është rasti ynë konkret në rastin e administrimit të pasurive kulturore botërore. Jemi këtu në rastin e një pasurie botërore, UNESCO, dhe për këtë arsye kjo marrëveshje administrimi ndjek të gjithë procesin e saj deri në fazën finale të ratifikimit të Kuvend. Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje Ministria e Kulturës themelon një fondacion të posaçëm. Partnerët e këtij fondacioni janë Ministria e Kulturës dhe Fondacioni Amerikano Shqiptar për Zhvillim. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është lidhur më herët dhe është regjistruar fondacioni në gjykatë.

Sot jemi duke parashtruar këtu marrëveshjen e administrimit të këtij fondacioni Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit me Ministrinë e Kulturës. Ky fondacion është jofitimprurës. Duhet theksuar për shkak edhe të dezinformimit të vazhdueshëm që është bërë si në komisione por edhe jashtë komisioneve, është një fondacion i cili çdo të ardhur të tij e mbledh në arkën e Butrintit. Ta ardhurat e Butrintit janë jo vetëm të ardhurat parësore, pra të ardhurat që vijnë nga biletat, por edhe të ardhurat që vijnë nga shërbimet e tjera. Patjetër që

pikësnyimi ynë është që këto ët ardhura të shtohen ende më tepër me shërbime të shtuara, dhe është e rëndësishme për të theksuar se në bazë të kuadrit ligjor ligji i njeh të gjithë të drejtën këtij fondacioni që jo vetëm të menaxhojë këtë entitet të ri, por të vazhdojë dhe të kërkojë partnerët të tjerë dhe donatorë të tjerë në fondacion. Ky është edhe objektivi ynë. Forma e re e menaxhimit patjetër që sjell një zhdërvjelltësi në formën e zhdërvjelltësisë burokratike, pra për të shmangur ato pengesa burokratike dhe themeli i fondacionit nëpërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondit Amerikan për Zhvillim ka ndjekur procesin ligjor sipas kuadrit ligjor në fuqi. Pra, janë marrë vendimet në këshilla të ndryshëm, Këshilli i Menaxhimit të Pasurive, një organ i ri që krijohet sipas ligjit të trashëgimisë, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe ky partner tashmë duke marrë statusin e partnerit, i cili mund të ndjekë linjat guidë të planit të menaxhimit të integruar paraqitet këtu pranë jush për miratimin e kësaj marrëveshjeje administrimi.

Ka pasur paqartësi në komisione të tjera dhe në opinionin publik edhe për përfshirjen e ekspertëve shqiptarë. Përfaqësimi i ekspertëve shqiptar ka ndodhur që në vitin 2018 në hartimin e termave të referencës të planit të menaxhimit më pas në të gjitha draftet e rishikuara të planit të menaxhimit të integruar. Edhe një herë po e ritheksoj, ky është një plan bashkëpropozimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës. Fakti që sot kemi prezentë edhe përfaqësuesit e Institutit të Arkeologjisë është që së bashku me këtë marrëveshje administrimi ne sjellim këtu edhe një protokoll bashkëpunimi midis Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe Institutit të Arkeologjisë. Një nga objektivat primarë të planit të menaxhimit dhe një nga detyrimet që i lind Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit është pikërisht ruajtja, konservimi, restaurimi dhe mirëmbajtja e sitit arkeologjik, por në këtë rast shtohet edhe një komponent kërkimor shkencor, duke shtuar grupin *Butrinti Research Group*. Ky do të jetë një grup i kërkimit shkencor, ka lindur në bazë të diskutimeve që në planin e menaxhimit dhe është konkretizuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Gjithashtu, dua t'ju sqaroj që kemi fonde të dedikuara, të parashikuara në planin e biznesit si për ngritjen e këtij grupi kërkimor-shkencor, ashtu edhe për aktivitetin e këtij grupi përgjatë 10 vjetëve të menaxhimit të fondacionit. Është e vërtetë, siç jua thashë, që do të jetë një marrëveshje 10-vjeçare. Një vit përpara përfundimit të kësaj marrëveshjeje palëve u lind e drejta që të rifillojnë negociimin për rilidhjen ose zgjidhjen e kësaj kontrate. Pra, marrëveshja është 10-vjeçare dhe në fundin e saj rifillon i gjithë procesi i negociimit, siç ka ndodhur deri tani me të

gjitha instancat, duke kaluar po njësoj që nga vendimi i Këshillit të Ministrave dhe duke u riparqitur pranë këtë komisioni.

Ka shumë elemente që lidhen me aspekte ekonomike, por do t'i evitoja, pasi i kemi shprehur dje gjerësisht të gjitha elementet shifrorë. Sa i përket këtij komisioni, ato çfarë janë të rëndësishme dhe që lidhen me pjesën e konventave, besoj se i kemi sqaruar.

Radhën e kaluar anëtarët e komisionit shtruan pyetje të pakta, më tepër të një informacioni të përgjithshëm mbi këtë plan, për shkak se u vu re që nuk kishin pasur kohë në dispozicion për t'u konsultuar gjerësisht. Ne jemi të hapur për të ridiskutuar ose për të ripasur pyetjet, pasi tashmë ka kaluar një periudhë e gjatë disaditore dhe mendoj se të gjithë anëtarët e komisionit i kanë marrë informacionet e duhura për të shtruar pyetje ose sugjerime mbi materialin që kanë.

Mimi Kodheli – Ju falënderoj, zonja Ministre!

A keni ndonjë gjë për të shtuar para se t'ia jap fjalën relatorit?

Po, zoti Mata, fjala për ju.

Martin Mata – Dje, unë, Sandri dhe ekipi ynë ishim për herë të parë në këto lloj seancash dhe ajo që ndamë me Komisionin e Ekonomisë ishte një praktikë e re për ne, sepse nuk e kishim menduar ndonjëherë që do të vinim në këto salla. Ajo që unë besoj se ka rëndësi për t'u ndarë në emër të AADF-së me anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme është që fondi dhe fondacioni kanë 27 vjet që operojnë në Shqipëri, pothuajse për shumicën dërmuese prej jush është i njohur aktiviteti i tij. Misioni, qëllimi i organizimit dhe i ekzistencës së këtyre dy institucioneve në Shqipëri lidhet ngushtë me ndërtimin e modeleve, të cilat e bëjnë Shqipërinë më të dallueshme dhe më të konkurrueshme sot në një treg ku, edhe një herë, siç e thashë dje, Shqipëria e gjendur sanduiç, po flas specifikisht për sektorin e trashëgimisë kulturore, ka më shumë nevojë se kurrë për të tërhequr fonde dhe vëmendje, si dhe modele menaxhimi që të jenë konkurruese, moderne, të qëndrueshme dhe kjo është arsyeja e vetme pse AADF-ja ka shtuar në portofolin e vet të projekteve edhe Butrintin.

Pra, nuk është qëllim në vetvete, por është prova e radhës për të provuar që atë që kemi bërë, duke u nisur nga muzeu “Marubi” në Shkodër, 9 qendrat urbane historike të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, Muzeu i Hebrenjve në Vlorë, Piramida dhe amfiteatri i Durrësit, që janë të radhës. Butrinti është vetëm prova ku AADF-ja përveç fondeve financiare të qenësishme do të mundohet të ndihmojë dhe të sjellë atë rol të vetëm që filantropia në mënyrën më tipike bën në

Shtetet e Bashkuara, transparencën, qëndrueshmërinë dhe modelin e drejtë të administrimit (menaxhimi, në fakt është fjalë e huazuar e huaj), i cili bën të gjithë diferencën sot, në dijeninë tonë 27-vjeçare, se si partnerë, donatorë, palë të huaja të interesuara apo vendase për të shtyrë më tej një zhvillim të qëndrueshëm të një perle si Butrinti, duhen për vitet dhe dekadat që do të vijnë.

Në punën tonë të përditshme ne jemi marrë shumë me Butrintin, janë mbi 12 vjet, kemi punuar me të gjitha qeveritë në këtë vend majtas dhe djathtas dhe e përbashkëta që ne kemi gjetur nga të gjithë politikëbërësit dhe vendimmarrësit në Shqipëri ka qenë një mbështetje e pakushtëzuar për Butrintin si një nevojë ulëritëse që të menaxhohet më mirë, që t'i japë atij statusin, ndoshta për herë të parë, të një prej njollave në *carbon free*, të çliuara nga karboni në të ardhmen, e një qendre, e cila në përputhje të plotë, siç kemi bërë edhe prezantimin në institucionet drejtuese të UNESCO-s së bashku me Ministrinë e Kulturës, të një prej modeleve, i cili zgjon shumë interes dhe mbështetje. Duhet thënë që këtë e kanë provuar edhe vende të tjera, por rezultatet kanë qenë mikse.

Të nderuar ligjvënës, dua t'ju siguroj se të gjitha të pavërtetat, për fat të keq, edhe akuzat, janë një merak që shkon edhe në nivelet më të larta të bordit tonë për Fondacionin Amerikano-Shqiptar të Zhvillimit, i cili në fillim u akuzua se do ta privatizonte Butrintin dhe pasi ra vala e parë u kuptua që fondacionit ligjërisht dhe praktikisht nuk i lejohet të privatizojë asnjë centimetër katror në këtë vend. U fol që do të merrte me koncesion. Ne vazhdojmë ta themi pa u lodhur që Fondacioni Amerikano-Shqiptar për Zhvillim nuk mund të marrë me koncesion dhe nuk mund të tjetërsojë asnjë lloj prone në Republikën e Shqipërisë, sepse i tillë është statusi ynë i aprovuar dhe i krijuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pasi na u tha që do të ndërtojmë hotele dhe resorte në zonën përreth Butrintit, natyrisht me përgjegjësi të plotë dhe profesionalizëm ju deklarojmë që nuk i lejohet, nuk e ka për qëllim dhe nuk mundet që AADF-ja të merret me zhvillime resortesh dhe projekte të kësaj natyre. E gjithë përpjekja jonë është që Butrinti të vazhdojë të marrë fonde dhe AADF-ja është magneti, mënyra më e mirë, këtë e kemi mësuar sot nga të gjitha bisedat që kemi bërë me institucionet e huaja ndërkombëtare, filantropike apo jo, të cilat nëpërmjet nesh kanë parë një mundësi që nëse ky model realizohet në të ardhmen të vijnë dhe të dedikojnë më shumë fonde, edhe më shumë burime njerëzore apo materiale.

Dje me Komisionin e Ekonomisë ndamë 2-3 shifra që janë jashtëzakonisht domethënëse për atë që quhet “filantropia botërore”. 471 miliardë dollarë u ngritën në Shtetet e Bashkuara në vitin 2020 nëpërmjet filantropisë, 20 miliardë prej tyre...

Mimi Kodheli – Zoti Mata, ju kërkoj të jeni më shterues. E para.

E dyta, këtu nuk jemi për të diskutuar për suksesin e AADF-së.

Ju lutem, fokusohuni te marrëveshja nëse keni ndonjë për shtuar për atë që tha ministrja ose mund t’ju dedikojmë një seancë tjetër!

Është hera e parë që ju vini në këto zyra, besoj se është nder i madh për ju që hyni në këtë ndërtesë, pasi kjo ndërtesë është shtylla e demokracisë në Shqipëri, gjithsesi jeni gjithmonë të mirëpritur për të hyrë në këtë ndërtesë, pavarësisht se për ju është hera e parë dhe jeni i surprizuar në një mënyrë ose në një tjetër.

Nëse keni ndonjë gjë për të shtuar për marrëveshjen, thuajeni, përndryshe do të kalojmë te referimi dhe më pas te komentet dhe pyetjet e kolegëve.

Meqë e mora fjalën, i uroj mirëseardhjen, zotit Gjekmarkaj si anëtar jo i përhershëm, pra zëvendësues i këtij komisioni, si dhe zonjës Zhupa, e cila është e pranishme.

Uroj të keni mirëkuptimin e kolegëve, pasi jeni ulur në vendin e një kolegu që nuk është prezent, me mirëkuptimin që ju karakterizon këto kohët e fundit si opozitë, shpresoj që kolegu të ketë mirëkuptimin.

Zoti Mata, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

Më falni, e ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Klosi.

Blendi Klosi – Faleminderit, kryetare!

Kam diçka të vogël për procedurë. Për rekord ne e kaluam për diskutim këtë, kolegët e opozitës i bënë të gjitha pyetjet që kishin, të gjitha tezat nga A-ja te ZH-ja u hodhën në tavolinë dhe më pas kërkuan që të kishin transparencë për një material të caktuar, që besoj se tashmë është më se publik dhe ministria e ka ofruar. Kështu që mendoj se ne duhet të ndjekim një procedurë, për të cilën ramë dakord, pra, ta kalojmë thjesht në votim të këtij projektligji. Pa dyshim, unë nuk jam kundër asnjë hapësire për transparencë dhe besoj se të dy përfaqësuesit e dy ministrive dhe përfaqësuesit e fondacionit janë këtu që të japin shpjegime të nevojshme, por për procedurë parlamentare ne e kemi mbyllur këtë diskutim dhe një konsensus të arritur ndërmjet xhentëlmenësh ndërmjet ish-ministrit Shehu dhe ish-ministrit Majko na bëri që të shkojmë në votim në seancën e sotme. Por kjo ishte vetëm për pjesën e votimit. Këto janë edhe të regjistruara

dhe nuk besoj se ka vend për ta hapur këtë bisedë, megjithatë, e thashë vetëm për rekord, që ne i mbyllëm diskutimet dhe kaluam vetëm në proces votimi.

Mimi Kodheli- Faleminderit, zoti Klosi!

Zoti Shehu për procedurë.

Tritan Shehu- Faleminderit, zonja kryetare!

Ka një pasaktësi në atë që tha miku im, sepse ne nuk e kemi lexuar marrëveshjen, e cila u soll vetëm 16 orë përpara se të mblidheshim këtu. Pra, ne nuk e diskutuam marrëveshjen, sepse marrëveshja ka ardhur pasdite vonë. Unë thashë që pa lexuar marrëveshjen, pa studiuar, pa e konsultuar edhe me të tjerë, që janë më të kualifikuar se ne për këto çështje, ne nuk mund të diskutojmë.

Zoti Majko, me shumë mirëkuptim, ra dakord dhe ishim të dy dakord që ta shtyjmë këtë proces për herë tjetër.

Faleminderit!

Unë them të vazhdojmë normalisht, sespe marrëveshjen e kemi lexuar, disa nga ne janë konsultuar dhe kemi krijuar një mendim. Pa dyshim, ky është një debat shumë i gjatë.

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, përfaqësuesve të fondacionit dhe të ministrive!

Unë dua të fokusohemi te ligji, sepse herën e fundit ne patëm më shumë se një orë diskutime dhe do të doja të fokusohemi tek ai që është objekt i komisioni, pra, që ka lidhje me përputhshmërinë, me kuadrin rregullator dhe atë të marrëveshjeve ndërkombëtare, por pa u futur në çdo teknikalitet, duke qenë se ka komisione të tjera përgjegjëse që janë marrë me to.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Edhe unë jam dakord me opinionin e kolegut Xhafaj. Ky është një diskutim që ne e bëjmë shpesh këtu, pavarësisht se në disa raste u kemi hyrë teknikaliteteve, sigurisht edhe në interes të gjithkujt që është deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por, gjithsesi, ju rikujtoj, kolegë, që komisioni mblidhet për të parë realisht sesi marrëveshja përputhet me të gjitha marrëveshjet ku Shqipëria aderon.

Fjala për kolegun Çollaku.

Kreshnik Çollaku- Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qenë se mungova herën e kalua po mundohem ta them të plotë shqetësimin, por edhe disa çështje, të cilat do të më interesonin në mënyrë më specifike për debatin në fjalë.

Dua të them që në fillim se unë nuk jam një njohës i mirë i menaxhimit turistik apo siteve turistike dhe pjesa e fundit që më intereson dhe dua të angazhohem në debat është ajo e menaxhimit të vendeve të tilla dhe si mund të kthehet në mënyrë atraktive si një perlë e natyrës.

Unë nuk kam asgjë lidhur me fondacion dhe nuk jam njohës i mirë i punës së tyre, por kur kam pyetur, nuk kam dëgjuar opinione negative, dhe kam respekt, por çështja që mua më prek dhe ku do të doja që ju ta ktheni vëmendjen, qoftë ministria, qoftë fondacioni, apo ne këtu që vendosim, një pikëpamje tjetër që shkon përtej bukurisë natyrore apo kësaj perle turistike të Butrintit, është menaxhimi. Këto janë perla të turizmit, por janë edhe pasaporta ADN-je identitare.

Unë nuk e di nëse e njihni, por Edi Shukriu është një nga arkeologët më me zë në Kosovë, i cili ka një aktivitet shumë të gjatë, shumë sfidues dhe me dekada në kërkimet arkeologjike në Kosovë për kishat ortodokse, nëse ato ishin të një gjeneze shqiptare, apo sallave. Po jua them këtë, sepse dokumentet dhe studimet e tij, pra mbrojtja që Edi Shukriu, me kohë dhe me dekada i kishte bërë, dhe të tjerë arkeologë dhe historianë në Kosovë, dhe evidentuar këtyre fakteve të gjetura, sigurisht nuk ka përcaktuar, por është lexuar në tryezat e vendimmarrjes politike për pavarësinë e Kosovës dhe Gjykata Ndërkombëtare në Hagë. Prandaj, dua të them se momente të tilla, nuk dua të paragjykoj fare, dhe vende të tilla, si: Butrinti, si Bylisi e të tjerë, duhet të kenë një qasje e mbrojtjes strategjike të kërkimeve dhe gjetjeve shkencore.

Kam dëgjuar një debat të një prej arkeologëve më të mirë në këtë vend, emrin nuk po e them, i cili diskutonte për Bylisin, ku me dekada të tëra ka pasur beteja dhe debate shkencore për gjetjet në Bylis, nëse ishin të një trashëgimie ilire apo helene. Ky është një debat që zgjat, vendet i mbrojnë këta dhe kanë një lloj konservatorizmi në mbrojtjen e këtyre gjetjeve.

Me aq ekspertizë sa unë kam arritur të lexoj, ju keni një lloj modeli të marrë nga vendet e Europës, si: Italia, Franca e të tjerë, që, me thënë të drejtën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në raste nuk është, ky është lajm i mirë, sepse nuk do të doja që të merrni modele nga vende, ku problematikat e një lloj kompeticioni apo diskutimi për identitetet nacionale janë të zgjidhura. Unë them të shikoni ligjet e vendeve, të cilat kanë probleme, si Turqia, Greqia, Maqedonia...

Mimi Kodheli - Zoti Çollaku, a mund të bëjmë një pakt?

Kreshnik Çollaku- E mbylla. Shumë shkurt.

Mimi Kodheli- Kemi shumë diskutime dhe është *non sens* që ne, si komision, të vazhdojmë 5 orë.

Kreshnik Çollaku - E humba mbledhjen e parë...

Mimi Kodheli - Edhe unë e kam humbur mbledhjen e parë, por jam qartësuar, pasi kam lexuar procesverbalet dhe ju ftoj edhe ju t'i lexoni.

Kreshnik Çollaku - Preokupimi im kryesor është mënyra sesi do të menaxhohet, si do të kthehen, a do të ndërtohen hotele, apo si do të zgjerohet sipërfaqja. Preokupimi im kryesor është që garancinë e vetme për gjetjet, studimin dhe germimin ta kenë specialistë shqiptarë të certifikuar dhe të mbrojtur nga autoritete shtetërore shqiptare. Ky është preokupimi im i vetëm për këtë gjë.

Faleminderit për durimin, zonja kryetare!

Mimi Kodheli - Të lutem, faleminderit për komentin tuaj!

Zoti Dule, fjala për ju.

Vangjel Dule - Faleminderit, zonja kryetare!

Përpara se të kaloj në thelbin e diskutimeve, besoj se kemi të bëjmë me një keqkuptim midis nesh. Fakti që jemi komision për dhënie mendimi, nuk na kufizon që ne të japim një mendim të plotë, jo vetëm për faktin nëse përputhet me frymën e disa konventave ndërkombëtare, pasi roli i deputetit nuk mund të kufizohet me kaq.

Herën e kaluar patëm shumë pikëpyetje dhe këto pikëpyetje nuk ishin vetëm për komisionin tonë, por shoqëruan debatet në të gjitha komisionet e tjera. Këto pikëpyetje lindën nga fakti se një projektligj i tillë nuk i parapriu një konsultim publik. Kjo nuk është vetëm një çështje që deputetët u informuan 16 apo 24 orë përpara, por është një çështje madhore, ku duhet të përfshijmë të gjithë faktorët e jetës publike, aq më tepër ata që merren me aspektet kulturore të jetës së vendit. Për rrjedhojë, kjo duhet të jetë një përvojë dhe precedent negativ, i cili duhet të korrigjohet dhe, në këtë rast, jo vetëm për Ministrinë e Kulturës, por për të gjitha projektligjet e Këshillit të Ministrave, sepse, ashtu siç ne e kemi për detyrë të jemi integralë në trajtimin e projektligjeve, edhe ministrja po ashtu. Ministrja nuk mund të vijë këtu dhe të thotë që unë jam këtu vetëm për aspektin kulturor, sepse ajo përfaqëson ligjin, i cili është miratuar në Këshillin e Ministrave dhe si të tillë duhet të na e prezantonit këtu.

Zonja Ministre, ju parashtrova dy pyetje herën e kaluar, për të cilat nuk mora përgjigje prej jush, por e mora nëpërmjet leximit dhe rileximit të projektligjit. Pyetjet e mia ishin për trashëgiminë fetare, që përfshin Parku Arkeologjik i Butrintit dhe ju pyetja, nëse kishit kërkuar një ekspertizë, kryesisht për dy objekte kryesore, për bazilikën dhe baptisterin e Butrintit. Nuk ka pasur një diçka të tillë. Besoj se gabimet tuaja t'i ndreqë administratori i ri, nëse do të marrë përsipër përgjegjësinë.

Kur flitet për administrim, a e keni marrë parasysh faktin e turizmit fetar, i cili është një nga trendet më në rritje gjatë kohëve të fundit?

Ju mendoni se kur dikush të dijë se keni shpërfillur krijuesit e atyre vlerave, mund t'ju besojnë se do t'u bëni atyre një administrim dhe një prezantim të denjë, siç e meritojnë?

Së dyti, kam një shqetësim në lidhje me faktin nëse marrëveshja e re përfshin të gjithë hapësirën gjeografike të Parkut Kombëtar të Butrintit. Herën e kaluar nuk më dhatë përgjigje, sepse më thatë se është kompetencë e Agjencisë së Zonave të Mbrojtura. Pra, të thotë se cilat janë dhe si janë. Ju jeni përgjegjës vetëm për stitin arkeologji. Në të njëjtën kohë, pak më herët apo pak më vonë kemi edhe një vendim tjetër të Këshillit të Ministrave që një pjesë e sipërfaqes të ish-Parkut Kombëtar të Butrintit, në fakt, pronë e manastirit të ortodoks të Shën Gjergjit është dhënë për ndërtimin e një resorti që për mënyrë profanuese mban edhe emrin manastirit. Pra, ju keni vënë dorë me vendimet e Këshillit të Ministrave në hapësirën e Parkut Kombëtar të Butrintit në mënyrën më abuzive, më shpërdoruese dhe më skandaloze. Pra, pronat e një komuniteti fetar edhe hiqni nga hapësira e mbrojtur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është koment, është diskutim. Si qenka koment?! T'i thuash një ministre se është një vendim i gabuar dhe abuziv, qenka koment?!

Mimi Kodheli – Zoti Dule, ju lutem!

Është një akuzë, nuk është një koment. Ju ngritët një pyetje dhe do të merrni një përgjigje.

Vangjel Dule – Jo, jo nuk është pyetje, asnjëherë. Pyetjet janë bërë herën e kaluar.

Mimi Kodheli – Ky që po bëni është një koment. Kjo është një akuzë që po bëni. Ju lutem, kërkoj mirëkuptimin tuaj!

Vangjel Dule – Po e konkludoj, duke thënë se uroj që këto jenë vetëm disa aspekte që unë, për shkak të interesit tim, kam konstatuar dhe uroj që të mos ketë aspekte të tjera në kuadrin e administrimit të ri që po i rezervojmë Butrintit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Kush e dëshiron fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjalën e ka kolegja Zhupa dhe më pas kolegu Majko.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Gjonaj, e doni fjalën për procedurë?

Zonja Gjonaj, fjala për ju.

Ju kërkoj ndjesë, zonja Zhupa!

Etilda Gjonaj – Zonja kryetare, mbase u tha në mënyrë të përsëritur edhe nga kolegët e Partisë Socialiste në këtë komision: nëse do t'u qëndrojmë striktë kompetencave dhe përgjegjësi që ka Komisioni i Politikës së Jashtme, atëherë në mënyrë automatike ne nuk mund të futemi në thelbin apo në çështje të teknikalitetit të marrëveshjes së Butrintit. Domethënë, në momentin që ne e kemi për detyrë, për përgjegjësi jo thjesht si deputetë, ne nuk jemi në rolin e deputetit në pjesën e përgjithshme, ne jemi në rolin e anëtarit të Komisionit të Politikës së Jashtme dhe na duhet të shikojmë sa kjo marrëveshje bie në kundërshtim apo është në përputhje me ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Kështu që, ne u qëndrojmë strikt pikërisht përgjegjësi që kemi si anëtarë të Komisionit të Politikës së Jashtme dhe nuk zgjerohemi në pyetje që lidhen me pjesën teknike. Secili nga ne nuk është anëtar vetëm i këtij komisioni, secili nga ne është edhe anëtar i komisioneve të tjera, ku ka pasur diskutime dhe asnjë nuk pengohet, sepse e thotë Rregullorja, që të marrë pjesë në diskutimet për çështjet teknike në komisione. Kështu që në këtë pikë unë sugjeroj që ne t'u qëndrojmë pikërisht përgjegjësi që ka ky komision.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Zonja Duma.

Grida Duma – Faleminderit, zonja kryetare!

Në rast se deputetët do të gjendeshin në një tryezë komisioni vetëm për të parë anën ligjore të marrëveshjeve, ka stafe teknike të Kuvendit, të asistencës që e bëjnë këtë gjë. Nga ana tjetër, ju kur flisni për harmonizim me ligjet e marrëveshjeve ndërkombëtare, kjo nuk është as

çështje politike dhe as deputetësh, por është çështje e *acquis* që e harmonizojnë këtë me atë, por në rastin e një marrëveshjeje atipike që ka të bëjë me historinë, me arkeologjinë, me burimin e të tjera, kjo është shumë më tepër se sa kaq sa doni ju ta reduktoni.

Kam një këshillë për ju, kolegë të maxhorancës, sepse një pjesë prej jush kërkoni gjithmonë ta zbrisni çështjen e Butrintit në teknikalitete dhe tregoni vetëm kompleksin. Në rast se ju do të vazhdoni përsëri të thoni: shikoni, nuk hyjmë dot këtu, por do të hyjmë aty, por shiko se nuk na lejohet të hyjmë këtu, por na lejohet të hyjmë këtu, neve na është dashur dy javë për të marrë marrëveshjen. Sot e marrim marrëveshjen për herë të parë. Kjo tregon nga sjellja se ka një problem. Madje, po të kishte qenë sjellja e hapur për procedurë, ne nuk do të ishim këtu me tensione të caktuara. Pa diskutim, nuk ka asgjë që e ndalon një deputet të pyesë për marrëveshje të këtij tipi në vende të ndryshme dhe, siç kemi thënë ne, pala e opozitës, ministria duhet të përfshinte gjithmonë e më tepër individë të fushës dhe personalitete të fushës, sepse ata na tregojnë që ka vende që ecin dhe ka vende që nuk ecin. Pra, ne nuk mund të jemi dhe të shkojmë me një procedurë standarde procedurale, a thua se kjo është rruga e mirëfilltë e tradicionale antike e marrëveshjes (antike nuk shkon këtu, por e thashë për ironi). Pra, nuk është kjo një çështje për t'u diskutuar thjeshtësisht dhe vetëm proceduralisht dhe të mos e bëjmë më këtë diskutim, duke marrë kohë, sepse më interesante është të pyesim: a ka marrëveshje të tilla me site arkeologjike historike, në të cilat ndërtohen hotele apo merren në koncept, që duhet të jenë brenda sitit arkeologjik, sepse stonon në mendje dhe vesh? Në rast se kjo është një gjë e mirë, hajdeni ta pranojmë si gjë të mirë, por pasi është diskutuar. Pra, jemi në një situatë jo thjesht procedurale dhe teknike, aq më tepër që nuk besoj se kjo trupë deputetësh e shikon veten si trupë ekspertësh ligjorë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Duma!

Me gjithë dashurinë dhe respektin për t'i dhënë fjalën koleges Zhupa, meqenëse u ngritën disa pyetje e disa diskutime të para në lidhje me çështjen, sidomos ato që ngriti zoti Dule, zonja Ministre, a mendoni se në fillim duhet të jepni përgjigje, më pas kalojmë te kolegja Zhupa?

Fjala për ju.

Elva Margariti – Precedenti negativ ishte një nga elementet që ndesha gjatë komenteve në këtë proces për të mos pasur një konsultim publik dhe, patjetër, është një koment aspak i qartë dhe aspak i drejtë, sepse konsultimet publike, ashtu siç thashë, kanë ndodhur që në fillim të të

gjithë këtij procesi me hartimin e termave të referencës, me planin e menaxhimit të integruar dhe këto konsultime dhe dakordësi kanë kaluar përtej territorit të Shqipërisë, për sa kohë kjo pasuri është një pasuri botërore e UNESCO-s. Unë mund t'juja citoj edhe me data se kur kanë ndodhur këto konsultime. Kemi filluar që në maj të vitit 2018 për kornizën e re ligjore, është vazhduar në qershor të vitit 2018 dhe termat e referencës së këtij plani janë përgatitur në bashkëpunim me ekspertë shqiptarë dhe me ekspertë të huaj, më pas ato janë miratuar në Këshillin Kombëtar në qershor të vitit 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha këto kalojnë në fazat e konsultimit publik, sepse konsultimi është pjesë e të gjithë procesit të vendimmarrjes. Kemi pasur prezantimin e metodologjisë më 3 tetor të vitit 2018, që është zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar; takimi i dytë është zhvilluar në Sarandë më 3 tetor të vitit 2018 me institucionet vendore; takimi i tretë më 4 tetor të vitit 2019 me prezencën time, të kryetarit të Bashkisë së Sarandës; takimi i katërt në ambientet e Parkut të Butrintit me komunitetin në tetor të vitit 2019 për të vazhduar më pas, sepse, ashtu siç do të vazhdoj ta them, gjithmonë konsultimi publik përfshin një link publik, ku paraqitet materiali dhe çdo kush ka të drejtën për të paraqitur vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e tij. Ne nuk kemi një material që të na ketë ardhur jashtë institucioneve publike me këto rekomandime. Për ju të gjithë, që e njihni konsultimin publik dhe që po ankoheni këtu sot në komision për shmangien e këtij procesi, besoj se e keni të qartë, por unë dua ta them sot këtu në kamera për të qenë të qartë për të gjithë ata që na ndjekin që, kur ka një konsultim publik, ka një link publik, ku publikohet i gjithë materiali dhe presim të gjitha këto rekomandime. Emra të përveçëm ekspertësh nuk kanë sjellë asnjë rekomandim në periudhën e konsultimit publik.

Për sa i përket asaj a kemi marrë parasysh turizmin fetar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Dule, unë nuk ju ndërpreva.

Baptisteri janë rrënojat e kishës paleokristiane, ashtu si bazilika që ka disa faza, përfshin edhe fazën paleokristiane dhe kishën në akropol. Pra, të tria këto elemente, që bëjnë pjesë në qytetin antik, janë brenda zonës së menaxhuar nga Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit dhe janë pjesë e marrëveshjes së protokollit të bashkëpunimit dhe, duke qenë se janë brenda kësaj zone, përfshihen në zona, të cilat do të studiohen në vazhdimësi së bashku me Institutin e Arkeologjisë. Patjetër që është Instituti i Arkeologjisë dhe ekspertët e fushës ata, të cilët ndajnë

fazat kërkimore dhe fazat e shpëtimit, restaurimit ose të gërmimeve të reja. Nëse keni informacione të tjera të shtuara, patjetër që mund t'i pyesim ekspertët e fushës se si përfshihet elementi i ekspertizës dhe elementi arkeologjik në menaxhim. Unë ju shpjegova qartë që ne, për sa na përket për objektivat tona primare, kemi lidhur këtë marrëveshje bashkëpunimi për të mirëpërcaktuar linjat guidë që do të çohen përpara në këta 10 vjet. Këto linja nuk janë thjesht një kuadër bashkëpunimi, thjesht disa nene mbi të cilët biem dakord se për çfarë do të operojmë, por pasqyrohen me shifra konkrete në planin e biznesit. Pra, kemi fonde të dedikuara për kërkimin shkencor, për grante për studentët, për restaurime *in-situ* dhe për mirëmbajtjen. Ky është një element shumë i rëndësishëm, sepse në vite ka munguar një fond konsistent për të bërë mirëmbajtjen në të gjithë sitin.

Për sa i përket manastirit të Shën Gjergjit, që ju thatë, ai është jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk është pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, edhe pse më vjen mirë që ju e keni parë si pjesë të parkut.

Për informacion të këtij komisioni, meqë jemi në Komisionin për Politikën e Jashtme, dua t'ju sqaroj se Parku Kombëtar i Butrintit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, ka një shtrirje më të gjerë sesa prona që është e njohur si "Pronë pasuri botërore UNESCO". Pra, prona pasuri botërore UNESCO është 8500 hektarë, ndërsa në vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave thuhet se Parku Kombëtar i Butrintit, me sa mbaj mend, është 8630 hektarë. Gjithsesi, për sa i përket pyetjes suaj, është përtej zonës.

Nuk kemi pse të shpërfillim turizmin fetar. Ministria e Kulturës ka një program të dedikuar që quhet "Rrugët e besimit", ku gjen gjerësisht mbështetjen e donatorëve të ndryshëm për të çuar përpara mirëmbajtjen dhe restaurimin e teqeve, e kishave ortodokse, kishave katolike e xhamive. Aty ku Ministria e Kulturës punon akoma edhe më shumë është i gjithë rrjeti lidhës i tyre dhe i gjithë programi. Duke qenë se është një program kombëtar, ka më tepër mesazhin e tolerancës fetare, ka mesazhe jo vetëm të promovimit të identitetit fetar në vetvete, por edhe të bashkëjetesës fetare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për zonjën Zhupa dhe më pas për zotin Majko.

Ina Zhupa - Shumë faleminderit, e nderuar kryetare!

Është kënaqësi të jem prezente në komisionin tuaj. Kjo është hera ime e parë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, në drejtimin e kryetares. Isha në drejtimin e zotit Klosi dhe tani jam në drejtimin e kryetares.

Fillimisht dua t'i bëj me dije komisionit (në rast se ju keni një informacion më tepër, qoftë kolegët, qoftë kryetarja, mund të ma vini edhe mua në dispozicion), se me gjithë ato që ka publikuar Kuvendi dhe ato që na kanë ardhur nga Kuvendi, ne ende sot kemi mungesa në dokumentacion. Konkretisht, unë nuk e kam statutin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit. Nuk e di nëse e ka ndonjë nga ju, që të mund të ma vërë edhe mua në dispozicion.

Sipas asaj që na kanë vënë në dispozicion, që është krijimi i fondacionit, mjafton t'ju citoj faqen 7 të këtij vendimi, që thotë: “mënyra e zgjedhjes së organeve drejtuese dhe funksionimi i tyre përcaktohet me statutin e fondacionit.” Statutin e fondacionit ne nuk e kemi dhe nuk na e ka vënë njeri në dispozicion. Është shumë e rëndësishme kjo gjë. Ministrja e Kulturës, e cila propagandon se është kryetarja e bordit, ka një mandat 2 - vjeçar, ndërkohë që koncesioni është 10-vjeçar. Po më pas si do të jetë forma dhe kush do ta drejtojë këtë bord? A do ta drejtojë ...

Mimi Kodheli - Besoj se ministri, gjithmonë.

Ina Zhupa - Jo, sepse këtu thuhet: “ Kryetari bordit të drejtorëve për mandatin e parë do të jetë ministri i Kulturës me një mandat 2-vjeçar. Mënyra e zgjedhjes së organeve drejtuese dhe funksionimi i tyre përcaktohet me statut”.

Për aq kohë sa unë ...

Mimi Kodheli - Dakord. Gjithsesi, ministri do të jetë, sepse karrige ministri do të ketë gjithmonë te kultura.

Ina Zhupa – Ministri do të jetë anëtar i bordit, por nuk thuhet askund që do të jetë gjithmonë.

Mimi Kodheli – Është relevante kjo, Ina?

Ina Zhupa - Po, është e rëndësishme për të kuptuar atë që na kanë thënë gjithë këto ditë, me idenë që shteti nuk po e jep Butrintin, që është ministrja aty, që do të jenë ministrja dhe institucioni garantë dhe u arrit deri aty sa në Komisionin e Ekonomisë u tha se do të quhej edhe institucion publik.

Ndërkohë, bordi me pesë persona dhe i gjithë fondacioni, jo AADF-ja, por Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, që ka partner edhe AADF-në, është një OJF, një organizëm privat, i cili ka anëtar bordi dhe ministren e Kulturës.

Sipas dokumenteve, ministrja do të jetë kryetare e bordit për 2 vjet, por askund nuk thuhet se ka ndonjë të drejtë vetoje për të ndryshuar vendimet që mund të merren 4 me 1 në atë bord. Duke parë statutin e fondacionit kuptojmë edhe më shumë se cilat janë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kjo është kërkesa e parë.

Edhe pse kemi 2 javë që e diskutojmë nëpër komisione dhe flasim për dëshirë për të bërë transparencë, ne ende kemi dokumente të pasjella. Uroj që këto gjëra të mos bëhen me qëllim dhe ndërkohë kalohet nga komisioni në komision

Mimi Kodheli - Kolege Zhupa, ju kërkoj ndjesë, por kam një ndërhyrje!

Ju lutem, kërkesat të jenë të pabëra në komisionet e tjera!

Ina Zhupa - Jo, asnjëherë, është hera e parë.

Mimi Kodheli - Ndryshe, biem në një ritual që nuk ka sens.

Ina Zhupa - Mund të merrni rekordet e mbledhjeve në komisionet e tjera

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Zoti Dule!

Zëvendësministre, mbledhjen e drejtoj unë, ndaj do të kërkoja prej jush qetësi që ta dëgjojmë kolegen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, ju lutem, jemi shumë veta këtu për të folur se bëhet shumë zhurmë.

Po, Ina.

Ina Zhupa – Faleminderit, kryetare!

Është hera e parë që unë po e kërkoj statutin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse unë i kam ndarë çështjet sipas komisioneve.

Duke qenë se jeni Komisioni për Politikën e Jashtme, nuk e di nëse ju keni ndonjë dokument të UNESCO-s, të vënë në dispozicion nga Ministria e Kulturës apo nga zonja Margariti, sepse unë si anëtare në Komisionin e Edukimit nuk kam, por edhe komisionet e tjera nuk kanë, me aq sa unë kam pyetur. Thuhet se ne kemi pasur një shkëmbim të vazhdueshëm me

UNESCO-n. Duke qenë se ky është Komisioni për Politikën e Jashtme, këto miratime që këta pretendojnë se kanë marrë nga UNESCO për planin e menaxhimit të Butrintit, duhet të ishin të disponueshme për Komisionin e Politikës së Jashtme.

Për sa i përket ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Petro, ju keni votuar marrëveshje sekrete, kështu që

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

E kuptoj që nder zjarre për ata që kanë votuar marrëveshje sekrete.

Dispozitat që mundësojnë menaxhimin e Parkut Kombëtar të Butrintit nga fondacioni i huaj privat, pavarësisht nga ajo që mund të shitet, kanë një problem shumë të madh si me frymën, ashtu edhe me germën e Konventës së Parisit të vitit 1972 “Për trashëgiminë Botërore”.

Neni 5 është i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përcakton se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

Për të kaluar te Konventa e Parisit, neni 4 thotë: “Rolin e padiskutueshëm parësor të shteteve palë, të shteteve anëtare, në administrimin e pasurive kulturore dhe natyrore në territorin e tyre”. Neni 4 shprehet më se qartë. “Detyra për të siguruar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe përcjelljen për brezat të ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, që ndodhen në territorin e tij, i takon në mënyrë parësore dhe ekskluzive atij shteti”.

Si mund të zbatohen këto detyra, kur shteti nuk e menaxhon vetë sitin e trashëgimisë kulturore, por është thjesht anëtar i një bordi të një fondacioni privat?

Në nenin 6,1 ripohohet: “Sovraniteti i shteteve në territorin në të cilin ndodhet trashëgimia kulturore natyrore, respektohet plotësisht dhe këto të drejta pasurore duhet të mbrohen me legjislacionin kombëtar”.

Në nenin 6,3 thuhet: “Shtetet palë zotohen të mos marrin asnjë masë të qëllimshme, që mund të dëmtojë direkt ose indirekt trashëgiminë kulturore dhe natyrore që gjendet në territorin e shtetit palë”. Shpikja shqiptare ka filluar me ligjin e trashëgimisë kulturore, ku thuhet se shteti e

administron indirekt. Fjala “indirekt” automatikisht e heq shtetin, se nuk e administron. Pra, si të them unë që indirekt administroj Parlamentin. Pra, ose e administron, ose nuk e administron. Nuk thuhet “e administron indirekt”. E administron shteti ose e administron privati.

U tha këtu që magneti është AADF-ja. Jo, magneti është Butrinti, se për Butrintin do të vijmë njerëzit, nuk do të vijmë për AADF-në. AADF-së, Butrinti do t'i shtojë një punë më të madhe në portofolin e saj prezantues, që ç'është e drejta, përfitoj nga rasti të them se ka bërë punë, ka financuar punë të mira në Shqipëri, siç u tha edhe këtu, por kurrë nuk ka administruar dhe nuk ka asnjë eksperiencë për të administruar një *site* arkeologjik, si partner strategjik në administrim. Në VKM përcaktohet se cili është fondacioni dhe thuhet se partneri strategjik ka eksperiencë 5-vjeçare. Ndërkohë, partneri strategjik ka eksperiencë 5-vjeçare në dhënien e parave financim, por jo në menaxhim, se ndryshon shumë të japësh para për filantropi, të ndihmohesh është tjetër gjë nga menaxhimi.

Gjithashtu, edhe shqetësimi që ngriti kolegu Çollaku, që lidhet me identitetin dhe me historinë shqiptare është i rëndësishëm. Unë mund t'ju vë në dispozicion bibliografinë, që këta kanë përdorur edhe listën që na kanë vënë në dispozicion si palë dhe persona të konsultuar, ku shikoj që nuk ka ndonjë arkeolog shqiptar, i cili është marrë me Butrintin, apo që ka bërë punime për Butrintin. Nuk ka në asnjë rast një arkeolog shqiptar që është marrë me Butrintin, që ka vepra për Butrintin, që e njeh Butrintin, që ka gërmuar në Butrint, pra që ka një lidhje me Butrintin.

Sinqerisht, shumë nga ju mund të jenë edhe pedagogë, vetë kryetarja është pedagoge, unë do t'ia vë në dispozicion këtë bibliografi, por me këtë bibliografi që na është sjellë këtu, edhe një studenti i vitit të parë, në lëndën Shkrim Akademik, merr notën 4. Është një bibliografi pa vite, një bibliografi me libra përrallash. Unë do t'ju citoj njërin nga librat, “Shenjt dhe mëkatarë”, i cili është pjesë e bibliografisë mbi të cilën është bërë plani i menaxhimit të Butrintit. Domethënë, një nivel...

Për këtë plan janë paguar 250 mijë euro nga AADF-ja. Nuk e di, çfarë niveli ju kanë afuar ata që keni paguar, se nuk e keni bërë ju planin. Ju keni paguar kompaninë britanike *Prince and Pears*, në mos gabofsh, sepse është e parëndësishme para Butrintit. Meqë ra fjala, kjo është një kompani që ka 500 paund vlerë në themelimin e saj dhe dy veta që punojnë për të. Mund t'i shikoni. Pak rëndësi ka kjo, është e parëndësishme. E rëndësishme është ajo që i ofron Butrintit.

Literatura që është përfshirë në planin e menaxhimit në 3 libra dhe vetë plani i menaxhimit e shikon dhe e trajton Butrintin si vend të një kolonie greke, si pjesë e një qytetërimi greko-romak. Edhe dje në një komision tjetër, pyeta zotin Luan Bërzhita: A jeni ju dakord me këtë pohim? Ai tha: “Jo, nuk jam dakord me këtë pohim, nuk është e vërtetë, nuk është grek”. E keni në procesverbale. Në plan është e thënë. Kështu që, ai që është anëtar bordi, ndoshta mund të vendosë edhe balancat e vendimmarrjes, sepse janë 5 anëtarë dhe mund të vendosin balancat e vendimmarrjes.

Gjithashtu, Richard Hodges e thotë në punimet e veta, në librat e veta, në një nga literaturat që ju e keni në planin e menaxhimit, ka arritur deri aty sa për Sarandën thotë:“...edhe Saranda, ky qytet i bukur grek”. Pra, si Komisioni i Politikës së Jashtme këto janë çështje me rëndësi për atë që është identiteti kombëtar shqiptar.

Së fundi, pasi çështje të tjera i kam trajtuar dhe do të vazhdoj t'i trajtoj edhe në Komisionin e Ligjeve, është e rëndësishme të kuptohet që në botë asnjë *site* arkeologjik nuk ka një model të tillë menaxhimi. Ajo që po shitet si model fondacioni, nuk ka të bëjë me këtë rast. Cila do të ishte mënyra më e mirë, nge e cila mund të përfshihej fondacioni si bamirës si filantrop? Bordi i Butrintit, që ekziston sot, i cili është ngritur me VKM që në vitin 1998 dhe është përmirësuar në vitin 2002, ka anëtarë Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Turizmit, ka 8 anëtarë dhe unë po të doni jua lexoj, por në vullnetin për të përfshirë dhe privatë, qoftë me fonde, dhe siç mund ta kenë edhe vende të tjera, që i përfshinë privatët dhe nuk ka ndonjë gjë të keqe ta përfshijë edhe AADF-në, me VKM t'i shtojnë një anëtar këtij bordi publik shtetëror, i cili të jetë përfaqësuesi i AADF-së. Kështu, mund të monitorojnë, edhe fondet që japin vetë, edhe mbetet një bord publik me përfaqësi nga institucionet publike.

Pra, kjo është një mënyrë që ti e përfshin privatën, e përfshin donacionin, e respekton fondacionin, i cili ka prirje filantropike, nuk e paragjykon dhe e bën pjesë të bordit. Por, në rastin shqiptar është modeli hibrid.

Giora Solar, një izraelit, ka qenë anëtar i UNESCO-s, po them, babai i trashëgimisë kulturore, ka përgatitur një plan menaxhimi për Butrintin, zonja Kryetare, në vitin 2012, të paguar po nga AADF-ja, i cili nuk u publikua kurrë dhe nuk u bë kurrë dokument zyrtar, sepse donatorit, thotë ai, me sa duket nuk i pëlqeu, sepse nuk parashikonte menaxhim privat, Ai e kishte bërë studimin me ekspertë shqiptarë, të cilët ishin marrë me Butrintin dhe parashikonte një formë menaxhimi nga shteti, ku mund të krijoheshin, siç janë edhe në botë...

Mimi Kodheli – Zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Për ta përmbyllur.

Pra, mund të krijoheshin borde, të cilat përfshijnë edhe privatë, sigurisht edhe organe të tjera.

Për ta përmbyllur, kam nevojë për statutin e fondacionit dhe dokumentet e UNESCO-s.

Mimi Kodheli – Unë ju falënderoj!

Para se t'ia jap fjalën ministrit Majko, ju rikujtoj që është në të drejtën, mbase dhe në detyrimin tonë që, në qoftë se keni një propozim për përmirësimin e marrëveshjes, së projektligjit, jeni më shumë sesa të lutur ta bëni këtë gjë, sipas asaj që latinët thotë: *Carta canta e villan dorme*". Pra, ta bëni këtë dhe ta risjelim këtu, ta votojmë, ta komentojmë, ta vlerësojmë dhe kështu të mund të përmirësojmë edhe këtë projektligj që kemi sot në diskutim.

Ministri Majko.

Pandeli Majko – Unë mendoj se nga diskutimet që kam dëgjuar dhe po dëgjoj këtu, ka një kakofoni për sa i përket asaj që ne duhet të miratojmë dhe asaj që mendohet se mund të ndodhë. Për të sqaruar këtë, mendoj që ia vlen të bëj një sqarim si dëshmitar, por edhe pak si protagonist. Butrinti nuk është mbrojtur, për fat të keq, falë angazhimit administrativ të shtetit shqiptar, por mbrojtja e Butrintit i dedikohet një njeriu që quhet Lord Rothschild. Ai është njeriu që ka lobuar në të gjitha llojet e qeverive shqiptare, përfshirë edhe ato që kam drejtuar unë. Ai ka lobuar edhe në Bankën Botërore, edhe në UNESCO dhe Fondacioni Butrinti që sapo u përmend këtu ka të bëjë pikërisht me këto veprime.

Ajo që ngatërrohet është se kjo marrëveshje nuk bëhet për të gjithë parkun ekzistues, pra për parkun që quhet Parku Kombëtar i Butrintit. Në qoftë se do të hapni VKM-në e vitit 2022, e cila ndan parkun në disa shkronja, flitet edhe për zonën A3.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Mund ta vazhdoj unë, zonjë?

Dhe nuk ka të bëjë me asnjë ndërtim hotelerie, dhënie pronësie e të tjera. Përfaqësuesi i Fondacionit Shqiptar - Amerikan, tha që statusi i brendshëm ua ndalon atyre që të marrin në pronësi ndonjë copë kishe, ndonjë copë kështjelle apo ndonjë copë guri. Fondacioni Shqiptaro - Amerikan nga pikëpamja e sigurisë apo e statutit, hyn tek aktorët që ne i kemi besuar çështjen më të madhe të sigurisë kombëtare, që ka të bëjë me kartat e identiteti, e keni pjesë të projekti, dhe e keni angazhuar kur keni qenë në qeverisje, ju, zotërinj. Sot ky fondacion vjen si pjesë dhe

në vazhdim të punës që ka filluar lordi Rothschild me Fondacionin Butrinti. Fondacioni Butrinti kishte një rol, por flas më tepër si dëshmitar, që kishte të bënte me tepër me mbrojtjen e Butrintit, tani po flasim për menaxhimin dhe jo për të gjithë menaxhimin e parkut, por për atë që quhet zona A3. Ju lutem, hapni faqet e planit të menaxhimit, aty thuhet që në fillim: “Plani i menaxhimit të integruar të parkut urban për zonën A3”, në çdo krye faqe, plani i biznesit për zonën A3. Ajo që e ngatërron pak çështjen është se, pasi qeveria ka bërë planin e menaxhimit të integruar, ka bërë 3 dëgjese publike në vite, në janar të vitit 2022, zonja Ministre, në janar të vitit 2022 ju keni ndërruar kufijtë e Parkut Kombëtar të Butrintit, keni bërë një rishikim kufijsh, i cili nuk ka të bëjë fare me këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje është për A 3-shin. Në mos gaboj, ju keni bërë një ndryshim kufijsh te C 3-shi.

Ne duhet të dimë a ndikon ky ndryshim kufijsh në marrëveshje? Kam përshtypjen se duhen thënë ca gjëra, duke vënë pikat mbi “i”. Këtu nuk ka asgjë për të keqësuar apo për të fetishizuar apo për të ndryshuar strukturën, emocionet apo historinë e një siti, siç është ai i Parkut Kombëtar të Butrintit, veçanërisht te A 3-shi.

Që kultura greke dhe kultura ilire janë të ndërthurura, ky nuk është ndonjë mëkat i madh dhe të zihemi tani se cili është guri im dhe cili është guri yt. Ajo për të cilën jemi mbledhur ne sot për të diskutuar, është që ky menaxhim i ri do ta kthejë Butrintin në *brand*. Pra, ne si shtet shqiptar e kemi mbrojtur, ndërsa tani do të kalojmë në fazën e dytë: menaxhimin për ta kthyer atë një brand ndërkombëtar.

Kjo ishte ëndrra e *Royal Richard*-it, të cilin në atë kohë unë e dëgjoja me një lloj ironie, të them të drejtën, por i ironizuari duhej të isha unë dhe ca të tjerë që ishin në krahun tim dhe këtë duhet ta them pas kaq vjetësh.

Dyshimet që hidhen se mos Fondacioni Shqiptaro-Amerikan na bën diçka atje, unë mendoj se janë të tepërta.

Mimi Kodheli – E sigurt se nuk na e lëviz nga vendi.

Pandali Majko – E sigurt se nuk na e lëviz nga vendi, e sigurt se nuk na e shfityron...

(Ndërhyrje nga salla.)

Ju lutem! Ju kam dëgjuar me qetësi dhe po ju them se nga të gjithë këtu në tavolinë, unë kam ndjekur për një periudhë, të paktën, 20-vjeçare, kështu që do t’ju lutesha të më dëgjoni, siç ju dëgjoja.

Në këtë kuadër, menaxhimi i A 3-shit për ta kthyer atë në brand ndërkombëtar, mendoj se është një gjetje e goditur.

Ajo për të cilën unë nuk jam dakord me qeverinë, është që në kohën që ne diskutojmë këtë dhe keni bërë planin e menaxhimit, 2-3 muaj para se të na vinte këtu ndëroni kufijtë. Mund t'i ndëronit më pas, pasi ta kishim kaluar këtë. Nuk mund t'ia vinit këtë peshë marrëveshjes me Fondin Shqiptaro-Amerikan. Sigurisht që nuk ka lidhje, por duhej të dilnit ju e thoshit se nuk ka lidhje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, ministri Majko!

Fjala për ministrin Shehu!

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar të ftuar,

Zonja Ministre,

Të them të drejtën, jam përpjekur këto ditë të krijoj një mendim më konsistent, jam përpjekur të bisedoj edhe me arkeologë të vjetër, me kolegët tuaj që merren me këto çështje në Shqipëri, të lexoj edhe materialet e atyre që kanë botuar, qoftë të dëgjoj edhe ditët e fundit nëpër media, të dëgjoj edhe opinione nga jashtë Shqipërisë dhe nga matanë Adriatikut. Unë nuk mund të hyj dhe nuk dua të hyj në elemente teknike të menaxhimit, se nuk është domeni im dhe as hapësira e këtij komisioni.

Unë mendoj se së paku këtu kemi të bëjmë me një nxitim të pajustificuar. Këtu kemi një problem shumë të madh, duhet të jemi realistë, kemi të bëjmë me pasurinë kombëtare kryesore arkeologjike shqiptare.

Unë jam dakord me atë që tha zoti Dule dhe Majko se kemi të bëjmë me disa elemente që janë shumë të çmuar për një vend dhe asnjë vend në botë i qytetëruar dhe i përgjegjshëm nuk mund të marrë guximin që në këtë mënyrë, pa hapur së pari një debat shumë të gjerë publik, të bëjë një veprim të tillë me një përgjegjshmëri kaq të lartë.

Unë mendoj se kjo nuk mund të bëhet dhe nxitimi apo ajo mënyrë e fshehtë e veprimit që marrëveshja na u soll vetëm disa orë para mbledhjes së komisionit të kaluar nuk është bërë pa qëllim, të mos gënjejnë veten, por është bërë me qëllimin e qartë për të fshehur realitetin, se nuk ka arsye tjetër. Ne jemi parlament, ka një qeveri, ka shtet. Sillet marrëveshja, lihet kohë e gjatë

që të studiohet; ishim ne që kërkuam të shtyhet. Pra, të gjitha këto tingëllojnë se nën tavolinë ka diçka tjetër.

Kam biseduar me specialistë të vjetër në fushën e arkeologjisë dhe nuk kam gjetur askund një mendim pozitiv, së paku, dyshime të thella, por mendim pozitiv nuk kam gjetur, sepse janë njerëz që kanë kontribuar fort në arkeologjinë shqiptare.

Unë, personalisht, duke e parë edhe në prizmin e Komisionit të Jashtëm, gjej se kjo nuk u intereson interesave kombëtare. Kjo bie ndesh me interesat tona të Shqipërisë, sepse, realisht në këtë mënyrë menaxhimi i një pasurie kaq të madhe i kalon një të treti. Unë nuk kam asgjë me fondacionin, absolutisht asgjë. Fondacioni ka interesat e tij, ka këndvështrimin e tij, por ne kemi tonat si Shqipëri. Një pasuri e tillë, një vlerë e tillë duhet të jetë thjesht nën administrimin shtetëror. Fondacionet le të jenë kontributeve, siç janë kudo.

Nuk mund të bëhet në këtë mënyrë, në mënyrë kaq të njëanshme. Unë nuk dua t'ju akuzoj për interesa, por, së paku, akuzoj për miopi ndaj interesave të Shqipërisë për përdorimin e kësaj pasurie të madhe për imazhin tonë, për soliditetin tonë. Kemi shumë pak gjëra për të mbrojtur, që na japin identitetin si shqiptarë, fatkeqësisht. T'i japim edhe këto?! Fondacionet kanë rolin e tyre, fondacionet mund të jenë donatorë, nuk ka asgjë të keqe. Si në të gjithë botën, fondacionet kthehen në donatorë të këtyre pasurive.

Në këtë prizëm, unë e deklaroj votën time kategorikisht kundër. Kërkoj që të shtyhet, të vazhdojë debati i gjerë, por, në qoftë se do të votohet sot, do të votoj kundër.

Po shtoj edhe diçka tjetër. Në konsultim me juristë kam kuptuar se kjo bie ndesh edhe me elemente të legjislacionit shqiptar, por edhe të konventave ndërkombëtare, prandaj ruaj të drejtën, besoj edhe kolegët e mi që, në qoftë se do ta votoni, ta kalojmë në Gjykatën Kushtetuese.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shehu!

Urdhëroni, Ministre!

Elva Margariti – Faleminderit, zoti Majko, për sqarimin e saktë, shterues dhe sintetik!

Marrëveshja e administrimit, e sjellë pranë këtij komisioni, është pikërisht për zonën A3, zona pasuri kulturore e Parkut Kombëtar të Butrintit. Kjo është zona që Ministria e Kulturës administron me VKM dhe kjo është zona që ligj njej të drejtën ministrisë së Kulturës, sipas nenit 172, që të mund të lidhë marrëveshje për administrimin direkt.

Nuk ka, jo vetëm lidhje, por asnjë përplasje dhe asnjë mbivendosje me zonat e tjera ose me rishikimet e kufijve.

Dua ta hap këtu, meqë jemi në Komisionin për Politikën e Jashtme dhe besoj se ka më shumë fokus dhe qëllim në vetvete të flasim për UNESCO-n. Do të doja të filloja me konsultimin që kemi bërë me UNESCO-n për planin e menaxhimit të integruar, por duke i rikujtuar edhe një herë këtij komisioni, ashtu siç e kam bërë edhe në komisionet e mëparshme, që plani i menaxhimit të integruar është miratuar më 22 korrik 2020.

Nuk jemi këtu për të diskutuar për planin e menaxhimit. Ky plan ka filluar që në vitin 2018 me proceset e konsultimit publik me pjesën e marrjes së rekomandimeve, draftimit, rishikimit dhe në vitin 2020 është miratuar. Pra, çdokush që sot ulet dhe flet mbi planin e menaxhimit të integruar si një element, pjesë e kësaj tryeze diskutimi, ende nuk ka kuptuar materialin që ka përpara tij dhe përse po vjen në këtë komision.

Në takimet e bëra në qendrën e trashëgimisë botërore, në korrespondencën e kryer me UNESCO-n, dua të ndalem në një nga pikat, meqë u citua gjerësisht kjo e kufijve, pikërisht përcaktimi i saktë në hartë i tipologjive, sipas teknologjive më të fundit, ka qenë një nga kërkesat për t'iu bashkëlidhur në materialin e planin të menaxhimit të integruar. Janë lënë rekomandime që Shqipëria si për zonën e mbrojtur natyrore, ashtu edhe për zonën kulturore të ketë kufij të qartë të mirëpërcaktuar, që i bashkëlidhen vendimit të Këshillit të Ministrave dhe këtë kemi bërë në vazhdimësi.

Ministria e Kulturës ka mirëpërcaktuar me një vendim të Këshillit të Ministrave, sipas planit të menaxhimit, se cila është kjo zonë A 3, e cila ishte e cituar në hartë, por kishte disa koordinata të bashkëlidhura. E kemi kthyer në një kornizë të plotë ligjore në një akt me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas të gjitha procedurave ligjore, që na njeh edhe ligji ynë i trashëgimisë, edhe ligjet e tjera që njohin zonat në administrim nga shteti.

Për sa i përket pjesës së Parkut Kombëtar të Butrintit, siç e thashë, plani i menaxhimit është bashkëpropozim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës. Ministrinë, pas miratimit të planit, kanë vazhduar punën për implementimin e të gjitha linjave guidë dhe rekomandimeve të planit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mund t'ju përgjigjet për pjesën e saj.

Mimi Kodheli – Ta dëgjojmë kolegën Xhembulla, në respekt të të qenit ish-kolegia jonë dhe zëvendësministre, pastaj fjala për ju.

Almira Xhembulla – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Faleminderit ministres!

Faleminderit zotit Majko për pyetjen!

Në fakt, ka pasur një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022, pikërisht për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore që janë park kombëtar, ku bën pjesë edhe Parku i Butrintit. Është miratuar ndryshimi në sipërfaqe të ekosistemit natyror/ligatinor Butrint, i shpallur park kombëtar dhe ka një ndryshim të sipërfaqes nga 9424,4 hektarë në 8622,2 hektarë dhe një ndryshim të koordinatave të nënzonës të trashëgimisë, të peizazhit kulturor që besoj se nuk ka rëndësi ndoshta për sa u përket teknikaliteteve. Pra, nga parku është hequr një pjesë e urbanizuar e zonës së Ksamilit, duke zvogëluar totalin e sipërfaqes me 800 hektarë. Pse kemi ardhur ne në këtë vendimmarrje? Kjo pikërisht është pjesë e një procesi që ka nisur që në vitin 2019-2020, vit kur u finalizua, që korrespondon edhe me planin e menaxhimit të integruar të Butrintit, sepse në atë kohë është parë nevoja për të bërë një rishikim të të gjithë territoreve që kishin humbur tashmë karakteristikat për të qenë pjesë e sistemit të zonave të mbrojtura. Kjo vendimmarrje nuk është bërë vetëm për Parkun e Butrintit, por përfshin 11 parqe kombëtare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku në disa zona kemi shtim të sipërfaqeve, ashtu siç e dini, që korrespondojnë me objektivin kryesor që ka qeveria shqiptare dhe Ministria e Turizmit për të shkuar në një target të rreth 21% të sipërfaqes. Pra, thjesht është një pjesë, një ko incidencë të themi e procesit, sepse ky proces lidhur me rishikimin e sipërfaqeve të territoreve të zonave, rishikimin e statusit të tyre, kishte filluar që në shkurt të 2020-ës. Janë bërë takime konsultative, kanë qenë takime të organizuar në 12 qarqe të vendit, jemi mbështetur këtu përveç administratave të zonave të mbrojtura dhe stafit të ministrisë, janë bërë takime me përfaqësues të delegacionit europian, të ambasadave, të agjencive të ndryshme, si GIZ, SIDA, UNTP dhe të gjithë donatorët që na mbështesin ne në objektivat, që i kemi vënë vetes. Ndërkohë, ashtu siç e theksoi zonja Ministre, kjo kishte të bënte edhe për të respektuar kushtet dhe kriteret që kemi ndaj konventave të ndryshme ndërkombëtare, siç i ka Parku i Butrintit që është pjesë e konventës së Ramsarit dhe pjesë e disa konventave të ndryshme, që lidhen me trashëgiminë natyrore në këtë rast.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Elva Margariti – A mund të vazhdoj për sqarim?

Mimi Kodheli – Ministre, ju lutem ...

Elva Margariti – Për të mbaruar përgjigjet e pyetjeve, që lidhen me konventën.

Mimi Kodheli – Ministre, ju lutem!

Atëherë, unë besoj se keni ende përgjigje për të dhënë edhe për kolegen Zhupa apo edhe për ndonjë pyetje tjetër shtesë. Unë mendoj se ministrja do të japë përgjigje për çka ka mbetur deri në këtë moment që flasim. Me lejen tuaj, kërktoj 5 minuta pushim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull!

Me lejen tuaj, zonja Ministre, po ia jap fjalën kolegut Çollaku dhe më vonë, pa qenë nevoja që ministrja të japë përgjigjet deri në fund, kërktoj 5 minuta pushim.

Kolegu Çollaku, fjala për ju.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Diçka në shtesë, unë jua thashë edhe një herë që nuk kam asgjë në kundërshtim me idenë e re novatore të një menaxhimi modern, si një trajtim turistik të Butrintit, asnjë problem nuk kam me këtë gjë. Nuk kam asnjë lloj paragjykimi për fondacionin, jua thashë, dhe kërktoj ndjesë se nuk e kam njohur shumë, por kudo ku kam pyetur, kam marrë fjalë shumë serioze dhe nuk kam absolutisht asgjë. Çfarë mua më preokupon, të them të drejtën, dhe do të doja nga ministrja një përgjigje, mbase nuk e kam kuptuar dhe do të isha shumë i kënaqur që të ma sqaroni këtë gjë, është pikërisht, po e them hapur, ky konservatorizmi që duhet të kemi në trajtimin strategjik të këtyre siteve arkeologjike. Unë, të them të drejtën, kam respekt maksimal për ish-ministrin Majko dhe kolegët e tjerë, por më tremb kjo ideja që një gur këtu e një gur atje apo ideja a janë tonat apo janë të tyre. A e dini që për një copë të vogël qeramike të gjetur në një varr të vjetër, ndërron historia e varrit, ndërron historia e vendit dhe vihet në diskutim autoktonia mbi vendin. Kështu që ne këto gjëra nuk mund t'i neglizhojmë as për dëshirën tolerante, se jemi vëllezër e miq në këtë rajon, sepse ne vëllezër e miq jemi në këtë rajon, por edhe pretendojmë territorin e njëri-tjetrit ndonjëherë. Kështu që nuk ka asgjë të keqe dhe nuk paragjykoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë jua thashë debatin për Bylisin, njerëz shkencëtarë më kanë referuar që për një qeramikë në një varr vihet në diskutim identiteti, ku lufton edhe një palë, edhe pala tjetër dhe fqinjë jemi të gjithë bashkë. Mund të pyesni Neritan Cekën. Pra, vëmendja dhe merakun im, mbase ju paragjykoj, nuk dua të flas duke akuzuar, por ma kuptoni shqetësimin, është që unë do

të doja një sjellje më konservatore, le të ecim edhe më ngadalë, sidomos kur bëhet fjalë për gjermime, për inventarët e gjermimeve, për objektivat e gjermimeve. Kjo është çështje autoktonie, kjo është çështje identiteti dhe nuk është çështje menaxhimi modern. Lidhur me menaxhimin si ambient turistik, unë nuk kam asnjë problem, asnjë kufizim qoftë me kufij apo pa kufij këto gjëra i sqaroni ju, por te kjo pjesë unë kërkoj që të mos tolerojmë. Pra, le të ecim më mirë ngadalë, më mirë të rrinë, sesa të na hapen dhe të na tjetërsohen. Ky është shqetësimi im.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Çollaku!

Unë besoj realisht që nuk po flasim këtu për gjermime apo për procedura të tilla, por po flasim totalisht për tjetër gjë. Unë besoj se ish-ministri Majko dhe zotërinjtë këtu, që kanë ardhur të flasin për projektligjin, e kanë cituar në më shumë se një rast. Ne kishim disa pikëpyetje të tjera që kishin të bënin me respektimin e kornizës legislative që e tejkalon legjislacionin shqiptar, si UNESCO, konventa e Parisit e kështu me radhë dhe, pa dyshim, dhe të gjitha pyetjet apo shqetësimet që u ngritën në komentet dhe diskutime tuaja.

Nëse jeni gati, Ministre, do të marrim përgjigjet dhe më pas do të bëjmë 5 minuta pushim para se të marrim vendimin.

Zoti Koçi e ka fjalën pas ministres. Më pas do të bëjmë 5 minuta pushim.

Fjala për ju, Ministre.

Elva Margariti – Për pyetjen e fundit, e cila, në fakt, nuk ishte pyetje në vetvete, por ishte më tepër një ndjesi, një merak i shprehur në komision, patjetër që Ministria e Kulturës këtu është në tagrin e ruajtjes së çdo vlere të identitetit kombëtar, të çdo vlere kulturore të trashëgimisë materiale dhe jomateriale; ka një mision të saj jo vetëm ruajtjen, por dhe edukimin, përcjelljen te brezat.

Ajo për të cilën po diskutojmë sot nuk e tjetërson misionin e Ministrisë së Kulturës, por, përkundrazi, fakti që sot arrijmë në fazën e menaxhimit të siteve akoma më tepër përforcon idenë që jo vetëm e kemi ruajtur, siç tha zoti Majko, pra në këta 30 vjet kemi luftuar për ta ruajtur, por tashmë po fillojmë dhe po hedhim sytë drejt potencialit të zhvillimit jo vetëm të identitetit kombëtar, nëpërmjet kësaj vlere pasuri kombëtare dhe botërore, por edhe të gjithë zhvillimit të komunitetit përreth, sepse ata jetojnë në Parkun Kombëtar të Butrintit, jetojnë duke pasur në zemrën e së përditshmes një vlerë të tillë identiteti botëror dhe nuk kanë asnjë benefit.

Sot, me planin e menaxhimit, synojmë të arrijmë në 114 të punësuar. Aktualisht Butrinti ka 14 të punësuar. Patjetër që pjesa e parë është komuniteti lokal. Ka një ndërlidhje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që është mision i ministrisë, dhe është mision që u përgjigjet jo vetëm ligjeve shqiptare, por në rastin konkret, siç e thamë, edhe çdo marrëveshjeje ndërkombëtare dhe konventave.

U cituan nga persona të ndryshëm pjesë të konventës së UNESCO. Më lejoni t'i përmbledh. Do t'i lexojmë shumë ftohtë, shumë qetë dhe pa asnjë koment për atë që po lexoj. Besoj se do të kem mirëkuptimin tuaj për atë çfarë do t'ju paraqes.

Në nenin 4 thuhet: “Cilido shtet palë në këtë konventë pranon se detyra e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit të brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, referuar në nenet 1 dhe 2, dhe që ndodhet në territorin e tij, i përket kryesisht atij shteti. Ai do të bëjë gjithçka që mundet në këtë përfundim, deri në fund të burimeve të tij dhe, atje ku është e përshtatshme, me ndonjë ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në veçanti, financiare, artistike, shkencore dhe teknike, të cilat mund të jetë në gjendje për t'i përfituar”.

Në nenin 6 thuhet: “Ndërsa respektojnë plotësisht sovranitetin e shteteve në territorin e të cilave ndodhet trashëgimia kulturore dhe natyrore, e përmendur në nenet 1 dhe 2, dhe pa paragjykim ndaj së drejtës së pronësisë, e garantuar dhe nga legjislacioni kombëtar, shtetet palë në këtë konventë pranojnë se kjo trashëgimi përbën një trashëgimi botërore për mbrojtjen e së cilës është detyrë e komunitetit ndërkombëtar, si një i tërë, që të bashkëpunojë. Shtetet palë angazhohen, në përputhje me dispozitat e kësaj konvente, të japin ndihmën e tyre në identifikimin, mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, siç referohet në paragrafët 2 dhe 4 të nenit 11, në rast se këtë e kërkojnë shtetet në territorin e të cilave ajo ndodhet. Çdo shtet palë në këtë konventë angazhohet të mos marrë asnjë masë të paramenduar, e cila mund të dëmtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë trashëgiminë kulturore dhe natyrore, referuar në nenet 1 dhe 2, që ndodhet në territorin e shteteve të tjera palë në këtë konventë”.

Neni 17 parashikon se shtetet palë të kësaj konvente do të konsiderojnë dhe inkurajojnë themelimin e fondacioneve ose shoqatave vendase publike dhe private, qëllimi i të cilave është të

ftojnë donacione për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të konventës.

Këto kisha për konventën.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Kolegia Zhupa pretendon për disa pyetje që ngriti, për statutin...

Të lutem, Ministre, nëse mundesh...!

Zonja sekretare e Përgjithshme, fjala për ju.

Entela Cipa – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa u takon pyetjeve të zonjës Zhupa, i kemi bërë me dije, sepse në faqen e Kuvendit janë publikuar të gjitha materialet e mundshme. Statutin mund ta gjeni me një kërkesë të thjeshtë në gjykatë. Megjithatë, ne mund t'ju vendosim në dispozicion, si të gjitha aktet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Atëherë, zonja sekretare e Përgjithshme, ramë dakord që statutin mund të na i vini në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një palë mund të na e vendosë në dispozicion, përtej kërkesës në gjykatë, që besoj se në këtë rast nuk është e nevojshme.

Elva Margariti – Zonja Zhupa kishte disa kohë që e kërkonte dhe me të gjithë këtë periudhë...

Mimi Kodheli – Besoj se është më e thjeshtë se kaq, Ministre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

A kishit komente të tjera, përveç statutit?

Entela Cipa – Për sa u takon konsultimeve me UNESCO-n, komenteve të zonjës Zhupa, siç e përmendi dhe ministrja, kanë filluar që në shtator të vitit 2019. Është përcjellë drafti i parë i planit të menaxhimit. Kanë ardhur komente të gjëra, mbi 4-5 faqe, të cilat janë konsultuar, janë reflektuar në planin e menaxhimit.

Më 24 janar të vitit 2020 është bërë një takim, në të cilin kam marrë pjesë edhe unë, si dhe drejtoresha e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë, në drejtimin e ambasadorit, të cilin dua ta falënderoj! Është ndjekur me shumë kujdes nga ambasadori Ferit Hoxha, në atë kohë ambasador në UNESCO, procesi 2-vjeçar i konsultimit të planit të menaxhimit. Në takimet tona kanë qenë

prezentë dhe ambasadori, dhe përfaqësuesit e ADF-ës, dhe drejtoresha e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë, ku kemi prezantuar planin e menaxhimit. Kemi diskutuar bashkërisht dhe gjerësisht me ta dhe me drejtoreshën e qendrës rajonale, që mbulonte Shqipërinë, zonjën Rosler, për të gjitha linjat e planit të menaxhimit. Pas takimit të datës 24 janar janë paraqitur një sërë komentesh. Ne mund t'ju vendosim në dispozicion të gjithë...

Në datën 28 shkurt qendra e trashëgimisë botërore ka përcjellë komentet. Mund t'ju përmend disa nga komentet, të cilat u bënë nga një proces i gjatë konsultimi me ta. Më vonë, në datën 18 mars të vitit 2020, i kemi reflektuar komentet dhe në datën 5 maj ambasadori Hoxha ka përcjellë në qendrën e trashëgimisë botërore komentet tona përfundimtare. Pra, kemi ndjekur një proces të gjatë konsultimi edhe fizik, megjithëse në kushtet e pandemisë, të cilin e kemi të dëshmuar me dokumentacion.

(Zonja Ina Zhupa flet pa mikrofon)

Elva Margariri – Zonja Kodheli, siç e thashë edhe pak më parë, plani i menaxhimit të integruar i është bashkëlidhur si pjesë e procesit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...si pjesë integrale e procesit, që ka arritur, por nuk është pjesë e konsultimit apo vendimmarrjes në këtë komision.

Këtu paraqesim marrëveshjen e administrimit dhe të planit të biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në planin e menaxhimit të integruar vendoset forma e menaxhimit që do të implementohet në sit. Kjo formë e menaxhimit indirekt është e specifikuar në planin e menaxhimit.

Mimi Kodheli – Zonja Ministre, besoj se kjo që thoni ju është e qartë dhe nëse UNESCO do të kishte një problem, mendoj se ka dëshirë të plotë, për aq kohë sa siti është pjesë e saj, të kishte mundësinë e saj në rast se do të kishte diçka në diskordancë me legjislacionin në fuqi, mbi të cilën funksionon organizmi.

Pra, po flas për UNESCO-n, nuk e di sa e qartë isha.

Martin Mata – Zonja Kodheli, vetëm një fjali.

Mimi Kodheli – Jo, do të bëjmë 5 minuta pushim dhe më pas ...

Martin Mata – Ju lutem, një fjali, sepse përcakton thelbin pse ne jemi sot në këtë sallë, pasi në të kundërt nuk ka kuptim!

Mimi Kodheli – Do të bëjmë 5 minuta pushim dhe më pas ...

Martin Mata – Ju lutem, një fjali, sepse humbet kuptimi!

Mimi Kodheli – Do të bëjmë 5 minuta pushim.

Martin Mata – Zonja Kodheli, nëse ...

Mimi Kodheli – Jo, jua kam mbyllur mikrofonin.

Martin Mata – Një fjali, ju lutem!

Mimi Kodheli – Zoti Mata, mos insistoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhjen e drejtoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua kam fikur mikrofonin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju dëgjon askush.

Martin Mata – Në respekt të ardhjes ...

Mimi Kodheli - 5 minuta pushim.

(Rifillon mbledhja)

Mimi Kodheli - Rifillojmë mbledhjen.

Fjalën e ka drejtori i AADF-së, zoti Mata, dhe më pas kolegu Koçi.

Martin, fjala për ju.

Martin Mata – Faleminderit!

Unë do të thyej një rregull, që ne së brendshmi e kemi diskutuar shumë, dhe unë jam problemi, në fakt, sepse ndoshta bëhem më emocional se ç'duhet.

Arsyeja pse ne jemi ngritur nga zyrat tona dhe kemi ardhur për herë të parë në komisionin e parlamentit të Shqipërisë është në respekt të asaj që ju jeni, të asaj që ju përfaqësoni dhe bëni për vendin.

Siç mund ta keni ndjekur, AADF-ja ka bërë një njoftim për shtyp, të kuruar dhe të konsultuar me konsulentë ligjorë këtej dhe matanë oqeanit për të dhënë në mënyrë më të përmbledhur, më të saktë dhe më të qartë rolin, misionin, kontributin dhe pozicionin e fondit shqiptaro-amerikan të zhvillimit në Republikën e Shqipërisë, produkt i një marrëveshjeje midis qeverisë së shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe qeverisë shqiptare, ku misioni, roli dhe statusi i fondacionit janë të shkruara dhe nuk janë prirje filantropike, përfitim ekonomik, por për të

ndihmuar në të zhvillim, për të mbështetur me filantropi, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe të shërbimit të qytetarëve shqiptarë.

Ndjesë që po citoj pjesë të misionit tonë!

Arsyeja pse ne jemi ngritur dhe kemi ardhur në zyrat e parlamentit të Shqipërisë dhe nuk kemi shkuar në studio televizive është sepse e ndiejmë detyrim të vijnë përpara jush, pasi duhet të shpjegojmë në mënyrën më përgjegjëse dhe më serioze atë për të cilën AADF-ja është.

Portofoli i AADF-së sot me projekte të aprovuara nga bordi ynë i drejtorëve, të emëruar nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara, është mbi 100 milionë dollarë, janë të gjitha për të mirën e vendit me përfitim ekonomik 0.

Tani unë kam një ftesë dhe ky është reflektim ndaj pozicionit tonë. Nëse gjeni njëherë të vetme, në cilindo dokument të planit të menaxhimit, të planit të biznesit të kësaj marrëveshjeje, të marrëveshjes tjetër që kaloi më parë, para 2 vjetësh, fjalën “koncesion”, AADF-ja tërhiqet sot. Nuk i lejohet AADF-së, si organizatë filantropike, e krijuar me vendim të këtyre 2 qeverive, të hyjë në koncesione, ku ka interes të përfitimit ekonomik. Nuk i lejohet, nuk mundet. Është e njëjta gjë si me akuzën që na u tha se do të privatizonim Butrintin, është njësoj si të na thoni që po marrim Piramidën. Pse nuk diskutojmë ne për amfiteatrin e Durrësit, kur në mënyrë identike, si pika uji, janë të njëjtat qasje, të njëjtat modele siç jemi duke bërë në Butrint? Pse nuk është e njëjta gjë për muzeun Marubi? Pse nuk është e njëjta gjë për muzeun e hebrenjve në Vlorë? Pse nuk është e njëjta gjë për qendrën historike në Vlorë? Për Pazarin e Ri? Për Vlorën? Është një detyrim ligjor shumë i fortë yni për të ardhur dhe prezantuar përpara jush çdo merak që ju keni, është e vetmja arsye, po e them edhe njëherë, sepse nuk është detyrimi ynë ligjor që të vijnë, por është detyrim profesional për ta ndarë me ju në dritën e diellit...

E dini se çfarë ka ndodhur në Butrint, zonja kryetare, se është shumë interesante për ta ditur? I bëmë dhuratë përpara disa ditësh biletarinë elektronike, e përfolur shumë këto kohë, sepse donim të bënim një provë se si do të reagoje siti i Butrintit. Nëse projekti do të ecte mirë, do ta shtrinim në të gjithë vendin, përsëri dhuratë. Kishim një aprovim nga bordi, nëse nuk gaboj, rreth 700 mijë dollarë për të bërë biletari elektronike në të gjithë vendin dhe qasja jonë ndaj bordit, ndjesë se po dal fare nga programi, por 2 minuta dhe do ta mbyll, është të pilotojmë njëherë, mësojmë dhe në qoftë se ecën, bëjmë më shumë dhe vendosëm ta bëjmë në Butrint. E vumë biletarinë elektronike dhe pas 3 muajsh të ardhurat e Butrintit u rritën me 240%. Ka filluar një betejë e heshtur që biletaria elektronike e Butrintit të mos punonte. Një herë nuk kishte drita

dhe u blemë UPS, pastaj nuk kishte bileta, blemë edhe bileta, kulmi arriti kur nga rreth 20 testera, që ka çdo ditë që ndizet biletaria dhe e provon, arriti të kishte rreth 3 mijë testera në ditë.

Ky është problemi që ka vendi ynë sot, ky është problemi që ka Butrinti. Modeli i menaxhimit sot është sfida më e madhe që ka *Louvre*-i, që ka *Versaille*-a, që ka *Yellowstone*-i, që ka *Stonehenge*-i dhe e vetmja arsye pse AADF-ja vjen këtu para jush sot është për të vazhduar atë kontribut të vetin që ka bërë në çdo vend tjetër në Republikën e Shqipërisë, përndryshe vazhdonim dhe bënim punë të tjera. Nëse do të ishte koncesion, me përgjegjësinë më të madhe, në respekt shumë të madh të interesit dhe merakut publik, që ka zonja Zhupa dhe të tjerë, i garantoj që fondacioni, AADF-ja, nuk do të ishte pjesë e kësaj, do të dilte, do të ikte.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zoti Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Drejtori në fjalën e fundit, në fakt, më ndihmoi, sepse pak a shumë jemi në një linjë. Përpara se të bëj 2 pyetje, dua të bëj 3 komente për 3 gjëra.

Së pari, ishte e qartë që këtu ka personalitete apo individë, them këtu në Shqipëri, në institutet tona, apo edhe në akademi, të cilët janë të interesuar për statuskuonë në menaxhimin e Butrintit. Pa diskutim, mund të jenë interesa të vogla, mund të jenë interesa të natyrës intelektuale dhe shkencore, pa dyshim nuk dua t'i përgoj, por në njëfarë mënyre duhen mirëkuptuar edhe që të bëjnë rezistencë për të mos lejuar ndryshimin e kësaj statuskuoje.

Komenti i dytë lidhet me një çështje, që në fakt unë nuk jam fare ekspert, por, meqë drejtoja Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, u kthye në një çështje ky plan biznesi i famshëm. Në fakt, duke mos qenë i fushës dhe nuk jam as investitor strategjik, as jostrategjik, nuk kam fare lidhje me investimet, këtë punën e sekretit tregtar unë nuk e mirëkuptoj. Jam kundër, jam kundër një kodi, që dikush e ka vendosur prej kohësh dhe është një lloj standardi ndërkombëtar, siç më thonë, por gjithsesi kjo ishte një nga arsyet që ky plani i biznesit nuk ishte bërë publik deri atë ditë. Sidoqoftë, marrëveshja ishte depozituar në Kuvend dhe çdo deputet kishte lirinë e plotë të vinte të konsultohet me marrëveshjen, që, në fakt, do të ishte e udhës të ishte bërë publike dhe të ishte në dispozicion në tryezat e komisioneve qysh në fillim. Gjithsesi, mendoj se kjo ka qenë një arsye, që ndoshta edhe është keqkuptuar në vijim të procedurave parlamentare.

E treta, që dua të them, është se shpesh në diskutimet tona, për të arritur qëllime politike, qoftë edhe për ego individuale, ne përdorim retorikë nacionaliste. Nuk dua të them se streha e kujt është shpesh retorika nacionaliste, por mendoj se në rastin konkret, ne nuk mund ta trajtojmë fondacionin shqiptaro-amerikan, si fondacion antishqiptaro-amerikan. Kemi të bëjmë me një instrument, që një partner strategjik, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka ndërtuar në marrëveshje me Republikën e Shqipërisë për të ndihmuar shumë procese dhe që deri tani kanë rezultuar të suksesshme dhe unë mendoj të vësh në dyshim këtë aspektin kombëtar të këtij fondacioni, nuk është normale. Jam dakord, le të gjuajmë nëpër arkivat e deklaratave, apo edhe në të tjera dokumente, elemente të cilat mund të na ngrenë pikëpyetje dhe eja t'i bëjmë, por, ju lutem, nuk është normale t'i trajtojmë disa çështje si marrëdhënie mes disa tradhtarëve dhe disa të tjerëve patriotë. Kështu që, do të doja të ishim shumë më objektivë dhe më realistë edhe në shqetësimet që ngremë.

Tani, kam 2 pyetje, që lidhen pak a shumë me këto që thashë.

E para, ka lidhje me përcaktimin shkencor të sitit të Butrintit. Ky administrim dhe menaxhim nga fondacioni a do të ketë impakt në përcaktimin shkencor të sitit dhe të të gjitha proceseve të mëvonshme, të zbulimeve arkeologjike, apo jo? Kjo është shumë e rëndësishme dhe është një shqetësim që e ngremë të gjithë. Pra, identiteti kombëtar ose identiteti kulturor dhe shkencor, ndryshon nga ky menaxhim, apo jo? Është shumë e rëndësishme. Këtu njerëzit kanë zbuluar që dikush, që është pjesë e bordit, ka bërë deklaratat, që kanë vënë një pikëpyetje për këtë autenticitet të sitit. Kështu, do ta doja një përgjigje dhe këtu përgjigjet janë gjithmonë zyrtare, e kam thënë edhe në Komisionin e Edukimit, këtu nuk është salla e parlamentit, ku njerëzit nuk mbajnë përgjegjësi për atë që thonë. Besoj se këtu mbahet edhe përgjegjësi penale për mënyrën se si flitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kam me ju fare. A ka mundësi? Nuk po të bëj presion. Je bërë si Saliu edhe ti tani. Na lër rehat.

Për përgjigjet zyrtare që vijnë këtu, mbajnë përgjegjësi atë që i thonë. Nuk mund të gënjejnë, nuk mund të mashtrojnë. Për këtë e kam fjalën, jo për diskutimet e deputetëve.

Pyetja e dytë ka të bëjë me procesin e mundshëm të gërmimeve të mëvonshme. Gërmimet e reja arkeologjike, që do të bëhen nën kujdesin e fondacionit ose nën periudhën në

të cilën fondacioni përgjigjet si menaxhues, do të bëhen nën autoritetin e Institutit të Arkeologjisë, apo jo?

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Koçi!

I vlerësoj pyetjet tuaja. Ndërkohë që, përpara se t'ia jap fjalën ministrit Shehu, dua të bëj një koment për atë që tha zoti Mata, unë nuk besoj që ka qenë qëllim i kolegëve të mi këtu për të lënduar apo për të ulur vlerën e fondacionit, nëse kjo gjë është bërë, kërkoj ndjesë në emër të të gjithë anëtarëve të Komisionit për Politikë e Jashtme. Ky nuk është fare qëllimi ynë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, absolutisht!

Ne fondacionin e njohim prej kohësh, e dimë aktivitetin tuaj, nuk është fare problem apo pjesë e diskutimit tonë. Pjesë e diskutimit tonë është totalisht një gjë tjetër që, sigurisht, ia ka vlejtur të marrë kohën e nevojshme për diskutim, sepse flasim për një copë sensitive të historisë sonë për gjithsecilin prej nesh dhe është në të drejtën tonë të kemi këtë sensibilitet të lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk kemi asnjë qëllim ta lëndojmë apo të vëmë në diskutim funksionimin e fondacionit.

Ministri Shehu, më pas Ina Zhupa, keni koment për të bërë, pyetje?

Ju lutem, besoj se keni pasur kohën e mjaftueshme për të bërë pyetje dhe komente.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj, unë personalisht në orën 11:30 kam takim me një ambasador të rëndësishëm. Jetojmë në kohë të vështira, prandaj me duhet të asentoj nga mbledhja dhe shpresoj shumë që do të kemi votuar deri në atë moment. E mbyllim pastaj me nënkryetarin, zotin Klosi.

Ministri Shehu, fjala për ju.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja kryetare!

Ne këtu jemi Komisioni për Politikën e Jashtme, jemi ish-ministra të Jashtëm, ish-ministra të tjerë, jemi njerëz të politikës së jashtme.

Realisht, unë, personalisht, dhe asnjë nga ne nuk ka asgjë me fondacionin, e thashë edhe pak më përpara. Fondacioni ka objektivat e tij, ka qëllimet e tij, ka politikën e tij, por gjuha që përdoret këtu, si gjuhë presioni, më duket e papranueshme dhe e patolerueshme për Komisionin e Jashtëm. Jemi në Kuvendin e Shqipërisë, në Komisionin e Jashtëm dhe këtu nuk ka gjuhë presioni dhe interpretime të gabuara dhe, absolutisht, që ato bien ndesh me realitetin këtu dhe kjo

vlen për këdo që vjen këtu në këtë sallë. Nuk kemi punë as me fonacionin, por kemi punën me qeverinë shqiptare, sepse këtë material e ka përgatitur qeveria shqiptare. Ne gjykojmë qeverinë shqiptare. Votojmë ose për një material të qeverisë shqiptare. Kush është i ftuar, ka ardhur si i ftuar, nuk ka ardhur vetë, e kemi ftuar ne, ose e ka sjellë qeveria, nuk e di se çfarë procedure është ndjekur, po këto janë rregullat e parlamentit shqiptar dhe realisht kjo është e vërteta. Ndaj, të jemi të qetë në këto gjëra dhe shumë etikë në këtë komision.

Faleminderit!

Mimi Koledhi - Faleminderit, ministër!

Zonja Zhupa, fjala për ju. Pastaj ministri Klosi.

Ina Zhupa – Faleminderit, kryetare!

Do të doja të bëja një ndërhyrje të shkurtër. Është e vërtetë që AADF-ja ka bërë financime për vepra kulturore në Shqipëri. Kjo është e pamohueshme, por në këtë rast kemi të bëjmë mirëfilli me marrjen në menaxhim nga një fondacion. Të dy zotërinj këtu janë anëtarët e këtij bordi, që do të menaxhojë Butrintin dhe jo si individë, por si përfaqësues të AADF-së. Pra, në këtë rast po flasim për një model, që nuk ekziston në asnjë vend tjetër të botës dhe të Europës në formën që e keni ju. Një model hibrid, i shpikur shqiptar.

Për ta mbyllur, fatkeqësisht, asnjë arkeolog shqiptar, që është marrë me Butrintin, që ka gërmuar aty, nuk është pjesë e këtij plani nga i cili rrjedh më pas marrëveshja për të menaxhuar Butrintin.

Faleminderit!

Mimi Koledhi – Faleminderit!

Fjala për zotin Klosi dhe më pas e hedhim në votim.

Blendi Klosi – Në fakt, do të doja të flisja pak më gjatë sa i përket diskutimit parlamentar që po bëjmë. Është nga të paktat projektligje që ka marrë kaq shumë vëmendje dhe diskutim në komision. Ndoshta po i rikthehemi normalitetit të jetës parlamentare. Nuk ka asgjë të keqe që diskutojmë dhe debatojmë, i shikojmë çështjet nga të gjitha këndvështrimet dhe në fund fare kjo është edhe detyra pse jemi këtu, që të bëjmë opozitën. Shumë mirë që opozita nuk bëhet vetëm nga një krah, por diskutohet në detaje nga të dyja krahët! E rëndësishme është që, edhe pas një diskutimi kaq të gjatë, edhe pse mbase si asnjë ligj tjetër rikthehet 2 herë në këtë komision për t'u ridiskutuar, sërish, në fund të bisedës ne arrijmë të dalim në disa konkluzione shumë të rëndësishme, trashëgimia kulturore, vlerat e kësaj trashëgimie, vlerat e zonave të mbrojtura dhe

gjithçka që ndodh në zonën e Butrintit janë një pasuri jona e përbashkët, që ne duhet ta mbrojmë me çdo çmim.

Ajo për të cilën duhet ta sqarojmë opinionin publik, edhe pas shpjegimeve të plota, shteruese dhe në detaje nga përfaqësuesit e të dyja ministrive, të cilët duhen falënderuar, sepse nuk ndodh shpesh që t'i vlerësojnë komisionet me kaq shumë kohë, është që trashëgimia, vlerat kulturore të zonave të mbrojtura, çdo centimetër dhe çdo detaj i këtyre pasurive kombëtare në të gjithë territorin e Shqipërisë vazhdojnë të mbrohen. Asgjë nuk ndryshon në zonën e mbrojtur të Butrintit, në sitin arkeologjik të Butrintit për sa i përket raportit me ligjin shqiptar dhe me institucionet shqiptare. Ky është në fakt thelbi i bisedës.

Pastaj mënyra se si do të menaxhohet nga një fondacion, i ngritur me drejtim maxhoritar nga institucionet shtetërore, nuk ka të bëjë me vendimmarrjen, por me institucionet që janë pjesë e saj. Ky fondacion ka vlera për sa i përket realitetit shqiptar dhe asaj çfarë ka bërë në Shqipëri në këta vjet dhe besoj se nuk ndryshon asgjë në menaxhimin e të këtij siti kulturor në raport me ligjin e trashëgimisë kulturore, mbrojtjen e çdo vlere, ashtu siç e thamë, qoftë edhe elementin e një tulle të gjetur, pra për të gjitha analizat që do të bëhen, janë po të njëjtat ligje, po të njëjtat rregulla, asgjë nuk ndryshon.

Fondacioni i krijuar është jofitimprurës. Pra, vlera që i japim këtij institucioni me ligj është mbrojtja ligjore për sa i përket funksionimit të tij dhe mosndërhyrja e politikës dhe administratës. Për hir të së vërtetës, siç dëshmoj kolegu Majko, në atë kohë kryeministër, ndërsa unë kam pasur nderin të shërbej në atë kohë si ministër i Kulturës, pra në vitet 2003-2005, ka pasur shumë debate, deri në nivelet më të larta të shtetit shqiptar, natyrisht edhe të qeverisë dhe shtetit anglez, sa i përket mënyrës se si menaxhohej fondacioni i Butrintit. Për këto debate në botën arkeologjike, në fakt, është shumë e vështirë të gjesh konsensus, pasi atje është një grup shumë më i vogël ekspertësh, që ne e kemi vështirë ta kuptojmë. Pra, gjërat duhen parë shumë më gjerë se kaq.

Pra, besoj se ky komision e vlerëson faktin që ne krijojmë një partneritet me një fondacion prestigjioz si Fondacioni Amerikan i Zhvillimit, i cili ka bërë vepra të mira publike për Shqipërinë. Besoj se do të duhet të kemi qartësinë, gjë që e dhanë edhe dy përfaqësuesit e institucioneve, sidomos ministrja Margariti, por edhe zëvendësministrja e Turizmit, që asgjë nuk ndryshon në raport me ligjet përkatëse të shtetit shqiptar për të ruajtur vlerat, trashëgiminë dhe prezantimin e këtyre institucioneve në një komunitet më të gjerë.

Ne themi që fitojmë nga Butrinti ose ka të ardhura prej tij, ne themi që Butrinti është një pasuri e madhe e Shqipërisë, por po ashtu themi se ne shfrytëzojmë një potencial shumë më të vogël se ajo çfarë mund të prodhojë Butrinti dhe i gjithë parku natyror, i mbrojtur tashmë, i zonës së Butrintit sa i përket turizmit, jo vetëm të trashëgimisë kulturore, por edhe të natyrës, lëvizjes në park për të prodhuar shumë më tepër dhe për ta bërë atë një institucion edhe më të besueshëm.

Besoj se edhe të ardhurat do të grumbullohen, të paktën për aq sa e kam ndjekur unë procesin, do të shkojnë edhe jashtë vetë sitit arkeologjik për ta transformuar të gjithë zonën e mbrojtur të Butrintit në një zonë atraktive, që të prodhojë shumë më tepër të ardhura. Në fund të fundit, ky është thelbi i të gjithë kësaj bisede.

Natyrisht, zhvillimet turistike në Shqipëri po ecin me hapa shumë të shpejtë, ne nuk mund ta lëmë Butrintin të jetë vetëm një pjesë e siteve tona, por duhet ta ngremë atë në nivelin e një konkurrence të fortë në rajon. Ndaj them që edhe ky debat që bëhet, në fund fare, përsëri është mirë për Butrintin, se i rikthen vlerat e debatit publik, natyrisht edhe vlerat e sitit. Ne kërkojmë ta mbrojmë dhe s'ka asgjë të keqe.

Nuk mendoj aspak që këto që thashë do t'i ndërrojnë qëndrimet e grupeve të ndryshme politike në këtë komision kur të votohet edhe në parlament, por besoj se maxhoranca do ta mbështesë me forcë këtë projektligj dhe jetën e mëtejshme të këtij siti.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Këtu mbyllen diskutimet.

Citoj për arsye procesverbali, që po hedhim në votim projektligjin “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 11 vota pro. 5 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

11 vota pro. 5 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

11 vota pro. 5 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

E hedhim në votim ligjin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

11 vota pro. 5 vota kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Falënderoj zonjën Ministre dhe zonjën zëvendësministre!

Falënderoj zotin Mata me stafin e tij!

Shpresoj të shihemi sërish!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA